

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5440
E hënë, 2 prill 2018
çmimi 0.40 €

Veseli i quan shqetësuese
deklaratat e Erdoganit
kundër Haradinajt **FAQE 4**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

**POROSIA E
IPESHKVIT,
IMZOT DODË
GJERGJIT, PËR
PASHKËT 2018** **F. 6**



**NË KOSOVË TË KRISHTERËT
FESTOJNË PASHKËT** **F. 6**

**TË DREJTAT E
NJERIUT SIPAS
KUSHTETUTËS SË
KOSOVËS** **F. 6**

Shkruan: Jakup
KRASNIQI



**PËRKUJTOHEN TË RËNËT E
MASAKRËS SË LYBENIQIT** **F. 10**

EKONOMI

**KRIPTOVALUTAT PËR NJË
JAVË HUMBIN 20 PËR QIND
TË VLERËS** **F. 8**

KULTURË

**JETON AJO KULTURË QË
VLERËSOHET** **F. 13**

Prof. dr. Drita HALIMI-STATOVCI

**FOLKLORI, MBROJTËS I
IDENTITETIT DHE KULTURËS
SHQIPTARE** **F. 14**

Mr. Kosovare KRASNIQI

SPORT

**PRISHTINA 'KËRCËNON'
VËLLAZNIMIN ME HUMBJE** **F. 20**

**DRITA, 3 PIKË PARA
PRISHTINËS** **F. 20**



FLET PËR "EPOKËN E RE" KËSHILLTARI I KRYEMINISTRIT, HALIL MATOSHI **FAQE 4-5**

Kosova dhe Turqia kanë marrëdhënie të mira

Këshilltari i kryeministrit Ramush Haradinaj, Halil Matoshi, ka thënë se Republika e Kosovës dhe ajo e Turqisë kanë marrëdhënie të mira. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai nuk ka dashur t'i komentojë deklarimet e fundit të presidentit turk

Rexhep Tajip Erdogan ndaj kryeministrit Ramush Haradinaj. Sipas tij, këto ngjarje nuk do të ndikojnë në raportet në mes të dy vendeve. Matoshi ka folur edhe për funksionimin e Qeverisë pas daljes së Listës Serbe. Ai ka theksuar se Qeveria

Haradinaj është duke i përmbushur agjendat e veta shtetërore sipas mandatit kushtetues. Duke folur për kërkesën e LDK-së për zgjedhje të reja, Matoshi ka thënë se LDK-ja si parti institucionale duhet të bëjë opozitarizëm serioz

Analistët thonë se Asociacioni s'mund të themelohet njëanshëm

FAQE 3

Zyrtarët serbë kanë paralajmëruar se Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe do të themelohet njëanshëm nëse

deri më 20 prill institucionet e Kosovës nuk fillojnë punën për themelimin e tij. Por, pavarësisht prej përcaktimit të këtij

afati, një gjë e tillë, sipas përfaqësuesve të partive politike dhe njohësve të rrethanave politike, nuk do të ndodhë



Trusti ka në menaxhim rreth 1.64 miliard euro

Kryetari i Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, Ymer Havolli, ka bërë me dije se trusti me sukses po arrin të përballet me sfidën e ruajtjes dhe rritjes së vlerës së

kontributeve pensionale që ka nën menaxhim. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se Trusti ka në menaxhim rreth 1.64 miliard euro **FAQE 8-9**

RENOVA
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Çarëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GRUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Kërkohen modalitete që Ligji i gjuhëve të hyjë në fuqi

Kryetari i Parlamentit maqedonas, Talat Xhaferi, ka thënë se po shqyrtohen mundësitë që Ligji për përdorimin e gjuhëve të shpallet në Gazetën Zyrtare dhe menjëherë pastaj të hyjë në fuqi edhe pa nënshkrimin e presidentit Ivanov



SHKUP, 1 PRILL - Partia më e madhe maqedonase në opozitë, VMRO DPMNE, pas kundërshtimit të Ligjit për gjuhët, që i mundëson një shtrirje më të gjerë përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe në të gjitha institucionet e Maqedonisë si dhe bojkotit të punës së Kuvendit, thotë se deputetët e saj, pas bojkotit, në momentin që do të kthehet në institucionin ligjdhënës, do të kërkojnë interpelancë për punën e Qeverisë.

Në një intervistë për "Radio Evropa e Lirë", lideri i VMRO DPMNE-së, Hristian Mickoski, thotë se partia e tij do të kthehet në Kuvend pasi të jenë përmbushur kërkesat politike dhe ato matematikore.

Mickoski me kërkesa politike nënkupton bisedimet që po zhvillohen ndërmjet grupeve të punës së partisë që drejton dhe social-demokratëve të kryeministrit Zoran Zaev. Ndërkaq me kërkesa matematikore ka apostrofuar lirin e deputetëve të kësaj partie, të cilët akuzohen për ngjarjet e dhunshme në Parlament më 27 prill të vitit të kaluar. "VMRO-DPMNE, po qe se vendos të kthehet në Kuvend, gjënë e parë që do të bëjë, do të dorëzojë interpelancë për punën e Qeverisë, ku deputetët e VMRO DPMNE-së do t'i shkoqisin të

gjitha ato keqpërdorime, ato gabime, të cilat kjo shumicë qeveritare në dhjetë muajt e kaluar ia shkaktoi atdheut tonë, ndërsa do të mund të shohim se si do t'u përgjigjet shumica qeveritare atyre apelimeve", ka nënvizuar lideri i opozitës maqedonase, Hristian Mickoski.

Ndërkaq kryetari i Kuvendit të Maqedonisë, Talat Xhaferi, në një takim joformal me gazetarët, ka thënë se po shqyrtohen mundësitë që Ligji për përdorimin e gjuhëve të shpallet në Gazetën Zyrtare dhe menjëherë pas kësaj të hyjë në fuqi edhe pa nënshkrimin e presidentit Ivanov, duke përfshirë mundësinë që ai ta nënshkruajë në vend të Ivanovit. Xhaferi, gjithashtu, tha se pret që opozita maqedonase të kthehet në institucionin ligjdhënës sepse, siç ka shtuar, deputetët e kësaj partie kanë shterur të gjitha argumentet për ta kushtëzuar kthimin e tyre në Kuvend.

Njohësit e çështjeve politike thonë se presidenti Ivanov ka dëshmuar se vepron në bazë të direktivave të VMRO DPMNE-së dhe nëse arrihet ndonjë marrëveshje ndërmjet opozitës maqedonase dhe socialdemokratëve, mund edhe të gjendet një modus që Ligji për gjuhët të dekretohet.

Nisur nga këtu, Xhelal Neziri,

njohës i çështjeve politike, e shihet dhe optimizmin e kryeparlamentarit Xhaferi, që të gjendet një mundësi që ky ligj të shpallet në Gazetën Zyrtare dhe të gjejë zbatim praktik. "Nuk përjashtohet mundësia, në rast të arrijtes së një marrëveshjeje mes pushtetit dhe opozitës maqedonase, që kjo e dyta të kthehet të përfshihet dhe çështja e nënshkrimit të Ligjit të përdorimit të gjuhëve apo gjetjes së një rrugëdalje që ky ligj të hyjë në fuqi. Pra, është e mundshme që ligji tashmë i miratuar në Parlament, të nënshkruhet në instancë të fundit nga presidenti i shtetit në një kohë të caktuar ose të gjendet një modalitet, i cili do të jetë në përputhje me Kushtetutën që ky ligj të hyjë në fuqi dhe të gjejë zbatim në praktikë", vlerëson Neziri. Ndërsa partia më e madhe maqedonase në opozitë, VMRO DPMNE, ka paralajmëruar protesta në maj, siç thotë kryetari i kësaj partie, Hristian Mickoski, për ta shprehur pakënaqësinë e kësaj partie kundrejt politikave të Qeverisë. "Paralajmërojmë protestë të madhe popullore, protestë në të cilën, siç thashë, VMRO-DPMNE do t'i shprehë të gjitha mospajtimet e veta me politikat momentale, të cilat shumica qeveritare e udhëhequr nga LSDM-ja po i bën", thekson Mickoski.

LAJME SHKURT



Rama: Nuk jam tërhequr, do të ketë ndëshkime në Kukës

TIRANË, 1 PRILL - Arrestimet kanë vazhduar në Kukës edhe të dielën. Të shtunën në mbrëmje qindra forca policie kanë bastisur shtëpi me urdhër të prokurorisë duke arrestuar dhjetëra persona.

Pas protestës të së shtunës të qindra qytetarëve në "Rugën e Kombit", të dielën kryeministri Edi Rama zhvillon një konferencë me gazetarët, pas deklaratës për shtyp, aty ku u komentua për frymëmarrjen, e cila ia vështirësonte përcjelljen e mesazheve.

Mëngjesin e së dielës, kryeministri Rama deklaroi se "policia ruajti gjakftohësinë përballë një tufe vandalësh që do ta marrë ndëshkimin që meriton". Kreu i Qeverisë theksoi se do të ndërmerret një komunikim intensiv shpjegues në lidhje me taksën sepse dezinformimi dhe manipulimi i opinionit publik ka triumfuar mbi shpjegimet që ne kemi dhënë gjatë debateve në ditët e fundit. "Ka nevojë për luftimin e dezinformimit që orkestrohet nga zjarrnxitësit e Tiranës. Kontrata është nënshkruar që prej dy vjetësh dhe sot ngrihet një furtunë në gotë e ndizet zjarr mbi pronën e përbashkët dhe mbi një investim që duhet ta dëmshpërblejë buxheti i përbashkët. Kur investimet sulmohen dhe digjen nga vandalë, ai që ka bërë investimin e kërkon atë mbrapsht nga shteti", tha Rama.



Basha: Tarifa e Rrugës së Kombit duhet të hiqet përfundimisht

TIRANË, 1 PRILL - Lideri i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, dënoi ashpër në "Facebook" arrestimet në mes të natës të qytetarëve të Kukësit dhe dërgimin e tyre në Tiranë, të gjitha të kryera, sipas tij, në shkelje të të drejtave të tyre themelore. "Veprimet e prokurorisë dhe të policisë janë të urdhëruara politikisht nga Edi Rama. Arrestimet nuk janë bërë për drejtësi, por për t'u hakmarrë, për të frikësuar dhe shantazhuar popullsinë e Kukësit dhe të Kosovës. Dënoj ashpër poshtërimin publik, fyerjet dhe përcjellimin që Edi Rama po u bënë qytetarëve të Kukësit dhe të Kosovës, të cilët protestojnë kundër grabitjes së dyfishtë që u bëhet dhe për të drejtat e tyre", ka shkruar Basha.

Kreu i PD-së në reagimin e tij kërkoi që tarifa e Rrugës së Kombit duhet të hiqet përfundimisht. "Tarifa e Rrugës së Kombit ka vetëm një qëllim: t'i grabisë qytetarët për të pasuruar Edi Ramën, i cili shpërdoron dhe vjedh 200 milionë euro taksë qarkullimi çdo vit për mirëmbajtjen. Edi Rama duhet të japë llogari se pse i shpërdoron dhe nuk i përdor këto fonde për mirëmbajtjen e rrugëve", tha Basha.

Analistët thonë se Asociacioni s'mund të themelohet njëanshëm

Zyrtarët serbë kanë paralajmëruar se Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe do të themelohet njëanshëm nëse deri më 20 prill institucionet e Kosovës nuk fillojnë punën për themelimin e tij. Por, pavarësisht prej përcaktimit të këtij afati, sipas përfaqësuesve të partive politike dhe njohësve të rrethanave politike, një gjë e tillë nuk do të ndodhë

**EPOKA
ERE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 1 PRILL - Ish-ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Sadri Ferati, e ka vlerësuar të panevojshëm paralajmërimin e Listës Serbe për themelimin e njëanshëm të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Ai ka thënë se kjo mënyrë e formimit të asociacionit është e papranueshme. "Themelimi i këtij asociacioni në këtë mënyrë është i papranueshëm. Ky asociacion është paraparë të miratohet në Qeverinë e Kosovës. Në këtë mënyrë paralajmërimi i tyre nuk është i mundshëm. Pra, themelimi i Asociacionit të Komunave Serbe në mënyrë të njëanshme është i papranueshëm dhe, si i tillë, nuk do ta ketë legjitimitetin dhe legalitetin e kërkuar. Kjo rrugë që kanë zgjedhur ata mendoj se dëmton edhe frymën e dialogut për normalizim dhe atë pjesën e pajtueshmërisë që e kanë pasur delegacionet tona shtetërore të cilat janë pajtuar të formohet asociacioni në përputhshmëri me Kushtetutën e Kosovës", ka deklaruar Ferati për gazetën "Epoka e re".

Ndërsa drejtori ekzekutiv i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka thënë se çështjen e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe askush nuk ka arsye dhe legjitimitet që ta shndërojë në një betejë politike. Sipas tij, kjo çështje tani ka një rrugë juridike e kushtetuese. "E sa i përket asociacionit, mendoj se kjo çështje tani ka një rrugë juridike e kushtetuese dhe nuk ka arsye e as legjitimitet askush ta shndërojë këtë çështje në një betejë politike", është shprehur Kryeziu për gazetën "Epoka e re". Ndërsa analisti politik Shkëlzen Maliqi ka thënë se si duket Lista Serbe ka ndryshuar mendimin sa i përket themelimit të njëanshëm të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Sipas tij, pas intervenimit të Vuçiqit, Lista e ka afatizuar këtë veprim për 20 prill, duke i lënë kështu hapësirë edhe Qeverisë së Kosovës për ta përgatitur variantin e vet të Asociacionit, ku nuk parashihen kompetencat ekzekutive. Megjithatë, Maliqi ka bërë me dije se serbët do të insistojnë që Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe të ketë kompe-



tenca ekzekutive, por ai ka thënë se për këtë nuk do të pajtohen kosovarët dhe faktori ndërkombëtar. "Ajo njëherë u ngut dhe tha se asociacioni do të themelohet të nesërmen e ditës kur reagoi ndaj arrestimit të Marko Gjuriqit, pastaj u tërhoq pjesërisht, mbase pas intervenimit të Vuçiqit, e ka afatizuar këtë veprim për 20 prill, duke i lënë kështu hapësirë edhe Qeverisë së Kosovës për ta përgatitur variantin e vet të Asociacionit, ku nuk parashihen kompetencat ekzekutive. Ndërkaq serbët do të insistojnë në këto kompetenca ekzekutive, për çfarë vështirë se mund të gjejnë pajtueshmëri jo vetëm te kosovarët, por edhe te

faktorët ndërkombëtarë", ka deklaruar Maliqi për gazetën "Epoka e re". Për çështjen e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe të dielën ka folur edhe kryetari i Listës Serbe, Goran Rakiq. Ai ka thënë se autoritetet e Kosovës nuk duhet t'ia lejojnë vetes që të përsëritet ajo që ka ndodhur më 26 mars në veri, ku ishte arrestuar Marko Gjuriqi. Sipas tij, deri më 19 prill Brukseli dhe Prishtina mund ta shpëtojnë fytirën, duke e themeluar Asociacionin. "Nuk mund të poshtëroni, të mos i përfillni njerëzit dhe të prisni që ata të mos mbrohen. Përfaqësuesit e serbëve kanë vendosur t'i ndihmojnë Brukselin

dhe Prishtinën që ta ruajnë fytirën deri më 19 prill, që ta nisim themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, ose ne do ta bëjmë vetë", ka thënë Rakiqi për mediet serbe. Marrëveshja për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ishte arritur më 25 gusht 2015, por Gjykata Kushtetuese e Kosovës më 23 dhjetor 2015 pati vlerësuar se disa nga parimet e përgjithshme të marrëveshjes për Asociacionin nuk ishin në harmoni me Kushtetutën e Kosovës dhe se këto parime duhet të jenë në pajtueshmëri me standardet kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Fëmijët me autizëm kërkojnë plotësimin e kushteve

PRISHTINË, 1 PRILL (ER) - Avokati i Popullit, Hilmi Jashari, i shoqëruar me zëvendësen e tij, Marija Raduloviq dhe bashkëpunëtorët, në javën që po lëmë pas ka vizituar fëmijët me autizëm në Shkollën Filllore "Ismail Qemali" në Prishtinë. Pasi që u informua për statusin dhe kushtet e punës së fëmijëve me autizëm, Avokati i Popullit ka pohuar se bëhet fjalë për diskriminim të tërthortë dhe se institucionet përkatëse duhet t'i plotësojnë kushtet e kërkuara me ligj, për të mundësuar që edhe fëmijët me autizëm mësimet në shkollë t'i vijnë në përputhje me nevojat e tyre specifike. Gjatë vizitës, drejtoresha e shkollës, Hatmane Demiri, ka njoftuar Avokatin e Popullit për numrin e nxënësve me autizëm, numrin e

përgjithshëm të fëmijëve me nevoja të veçanta, për kushtet në të cilën fëmijët mësojnë dhe aktivitetet e zhvillojnë, si dhe për punën e mësimdhënësve dhe ndihmësve të mësimdhënësve veçanta. Ajo ka paraqitur edhe një sërë problemesh të hasura nga nxënësit, si dhe prindërit e tyre. Demiri ka theksuar se studentët nuk kanë transport në shkollë, gjë që është një detyrim ligjor. Ajo ka thënë se buxheti është shumë i kufizuar dhe se shkolla nuk është në gjendje të marrë gjithçka që u nevojitet. Avokati i Popullit pastaj ka vizituar departamentin ku qëndrojnë fëmijët me autizëm. Në një bisedë me mësuesit e tyre, ata u informuan për shqetësimet e tyre rreth kushteve në të cilat qëndrojnë nxënësit.



Veseli i quan shqetësuese deklaratat e Erdoganit kundër Haradinajt



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, është shprehur i shqetësuar me deklaratat e presidentit të Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, të drejtuara ndaj kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, në një kohë kur institucionet e Kosovës po trajtojnë në hollësi veprimet që çuan në arrestimin dhe deportimin nga Kosova në Turqi të gjashtë shtetasve turq

**EPOKA
ERE**

Faton DERMAKU

PRISHTINË, 1 PRILL - Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan ka kërcënuar kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj, se do të japë përgjegjësi për menaxhimin e situatës me turqit e deportuar. Erdogan ka kritikuar kryeministrin e vendit për shkarkimin e ministrit të brendshëm Flamur Sefaj dhe shefin e AKI-së, Driton Gashi. Presidenti turk ka ftuar qytetarët e Kosovës të dalin dhe të protestojnë kundër Haradinajt. "Agjencia Turke e Inteligjencës me një operacion në Kosovë ka kapur gjashtë përfaqësues të gylenit. Por, kam një pikëllim. Kryeministri i Kosovës i largoi nga detyra personin në krye të inteligjencës dhe ministrin e Brendshëm. Unë tani pyes kryeministrin e Kosovës: Me udhëzim të kujt more një hap të tillë? Prej kur fillove t'i mbrosh ata që u përpoqën t'i bëjnë grusht shteti Republikës së Turqisë? Si mund t'i ushqesh këta

njerëz që kanë bërë një tentativë për grusht shteti ndaj Turqisë e cila mirëpret Kosovën si një vëlla. Do të japësh llogari edhe ti për këtë. Vëllëzërit e mi kosovarë nuk i japin kredibilitet një kryeministri si ti. Vëllëzërit e mi kosovarë, kosovarët që i njoh dhe i di, do të kërkojnë llogari prej teje për këtë. Unë e di edhe këtë", ka thënë Erdogan. Ndaj këtyre deklaratave kanë reaguar kryeparlamentari Kadri Veseli, Ministria e Punëve të Jashtme, zëvendëskryeministri Fatmir Limaj dhe ambasadorja Vlora Çitaku. Veseli ka shkruar në llogarinë e vet në "Facebook" se është shprehur i shqetësuar me deklaratat e presidentit të Republikës së Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, të drejtuara ndaj kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në një kohë kur institucionet e Kosovës po trajtojnë në hollësi veprimet që çuan në arrestimin dhe deportimin nga Kosova në Turqi të gjashtë shtetasve turq. "Këto deklarata janë shqetë-

suese, sepse vijnë nga lideri i një vendi mik, mbështetja e të cilit shtet është dëshmuar në vazhdimësi para dhe gjatë gjithë ekzistencës së shtetit tonë. Andaj, deklaratat e tilla nuk i kontribuojnë forcimit të miqësisë dhe bashkëpunimit të ndërsjellë, për çka vendi ynë ka qenë dhe është i përkushtuar", ka thënë Veseli, duke shtuar se veprimet e institucioneve të Republikës së Kosovës janë sovraane dhe, si të tilla, nuk mund t'u nënshtrohen presioneve të jashtme. "Në këtë drejtim, edhe marrja në përgjegjësi e bartësve të institucioneve të sigurisë është çështje e brendshme dhe në diskrecion të lidërshiptit të Kosovës. Republika e Kosovës do të vazhdojë pa kompromis rrugën e vet evropiane, të forcimit të vlerave perëndimore dhe demokratike, duke ofruar bashkëpunimin e vet me të gjitha ato shtete mike që duan raporte të respektit të ndërsjellë, duke përfshirë edhe Republikën e Turqisë", është shprehur Veseli.

Edhe Jetir Zyberaj, shef i kabinetit dhe këshilltar i lartë politik i ministrit të Punëve të Jashtme, Behgjet Pacollit, ka reaguar ndaj deklaratave të presidentit turk. Ai në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se Kosova ka institucionet e veta dhe ato udhëhiqen me përgjegjësi dhe respekt nga udhëheqësit e zgjedhur me votën e

popullit. Zyberaj ka bërë me dije se nëpërmjet kanaleve diplomatike në ditët në vijim do t'i sqarojnë arsyet e deklaratave të bëra nga presidenti Erdogan. Sipas tij, Kosova është e përkushtuar të kultivojë marrëdhënie ndërshtetërore me të gjithë partnerët ndërkombëtare, në këtë rast edhe me Turqinë. "Turqia është vend mik i Kosovës, vend që e ka mbështetur dhe e mbështet Kosovën në vazhdimësi. Nëpërmjet kanaleve diplomatike në ditët në vijim do t'i sqarojmë arsyet e deklaratave të bëra nga presidenti Erdogan, në pajtim me marrëdhëniet e mira që kemi si dy shtete dhe të parimeve të barazisë së shteteve sovraane dhe mospërzjerjes në punët e brend-

shme. Ne jemi të përkushtuar t'i kultivojmë marrëdhëniet ndërshtetërore me të gjithë partnerët ndërkombëtarë dhe me Turqinë mike. Dihet fare mirë se Kosova është e hapur për bashkëpunim dhe dialog me Turqinë në secilën fushë, pa pasur nevojë për interferim në punët e brendshme. Kosova ka institucionet e veta dhe ato udhëhiqen me përgjegjësi dhe respekt nga udhëheqësit e zgjedhur me votën e popullit", ka thënë Zyberaj. Ndaj deklaratave të presidentit turk ka reaguar edhe kryetari i Nismës Socialdemokrate, njëherësh zëvendëskryeministri Fatmir Limaj, si dhe ambasadorja e Kosovës në ShBA, Vlora Çitaku.

Erdogani falënderon Thaçin, kritikon sërish Haradinajn

Presidenti i Republikës së Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, ka falënderuar të dielën presidentin e Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, për arrestimin dhe dëbimin e gjashtë shtetasve turq nga Kosova. Gjatë një fjalimi të mbajtur në kongresin e rregullt të partisë në pushtet AKP, në provincën jugore dhe kufitare Hatay, president turk ka deklaruar se operacioni kundër Lëvizjes Gyleniste në Kosovë nuk ka qenë

as i pari dhe nuk do të jetë as i fundit, njofton agjencia shtetërore turke e lajmeve "Anadolu". "Prej këtu e falënderoj presidentin e Kosovës, por kryeministrin i them 'turp'. Largimi nga detyra i kreut të inteligjencës, ministrin të Brendshëm, të cilët na i dhanë anëtarët e organizatës terroriste FETO, është një gabim historik. Ata bënë detyrën e tyre", ka thënë Erdogan.

Flet për "Epokën e re" këshilltari i kryeministrit, Halil Matoshi

Kosova dhe Turqia kanë marrëdhënie të mira



Këshilltari i kryeministrit Ramush Haradinaj, Halil Matoshi, ka thënë se Republika e Kosovës dhe ajo e Turqisë kanë marrëdhënie të mira. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai nuk ka dashur t'i komentojë deklaratimet e fundit të presidentit turk Rexhep Tajip Erdogan ndaj kryeministrit Ramush Haradinaj. Sipas tij, këto ngjarje nuk do të ndikojnë në raportet në mes të dy vendeve. Matoshi ka folur edhe për funksionimin e qeverisë pas daljes së Listës Serbe. Ai ka theksuar se Qeveria Haradinaj është duke i përmbushur agjendat e veta shtetërore sipas mandatit kushtetues. Duke folur për kërkesën e LDK-së për zgjedhje të reja, Matoshi ka thënë se LDK-ja si parti institucionaliste duhet të bëjë opozitarizëm serioz

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 1 PRILL - Këshilltari i kryeministrit Ramush Haradinaj, Halil Matoshi, nuk ka dashur ta komentojë reagimin e presidentit të Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, ndaj kryeministrit Ramush Haradinaj për shkrimin e ministrit të Punëve të Brendshme dhe kreut të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë. Ai ka mohuar mundësinë që pas ngjarjeve të fundit mund të ketë tensione në raportet në mes të dy vendeve. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se të dyja vendet kanë raporte të mira. "Republika e Kosovës dhe Republika turke kanë marrëdhënie të mira", ka thënë Matoshi. Në këtë intervistë këshilltari i kryeministrit ka folur edhe për punën e Qeverisë

pas daljes prej koalicionit qeverisës të Listës Serbe. Sipas tij, Qeveria Haradinaj është duke i përmbushur agjendat e saj shtetërore sipas mandatit kushtetues.

Lidhur me mundësinë e kthimit të Listës Serbe në Qeveri, ai ka thënë se kjo do të ishte e racionale, meqenëse zyrtarët serbë në qeverisje janë kategori kushtetuese. "Lista Serbe besoj se do të veprojë në mënyrë racionale dhe t'i përfaqësojë serbët kosovarë në ekzekutivin e vendit, sepse zyrtarët serbë në qeverisje janë kategori kushtetuese. Ministri Sefaj është shkarkuar për një shkelje kushtetuese", ka thënë Matoshi. Ai u është përgjigjur edhe paralajmërimeve të LDK-së për zgjedhje të parakohshme. Sipas Matoshit, jetëgjatësia e Qeverisë së Kosovës nuk varet nga qëndrimi

i LDK-së. "LDK-ja si parti institucionaliste duhet të bëjë opozitarizëm serioz, duke ushtruar kontroll parlamentar mbi qeverisjen, si dhe të ndikojë në unitet kur janë në pyetje interesat madhore kombëtare të Kosovës, por nuk varet nga ajo jetëgjatësia e Qeverisë së Kosovës. Qeveritë teknike janë groteske. Si mund të funksionojë një Qeveri pa mbështetje politike? LDK-ja, megjithatë, në thelb e ka mbështetur Qeverinë Haradinaj", është shprehur Matoshi.

"Epoka e re": Z. Matoshi, kemi pasur një reagim të presidentit të Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, i cili ka kritikuar kryeministrin Haradinaj për shkarkimin e ministrit të Punëve të Brendshme (MPB), Flamur Sefaj dhe shefit të Agjencisë së Kosovës për

Inteligjencë (AKI), Driton Gashi. Cili është komenti juaj për këtë reagim?

Matoshi: Nuk kam koment.

"Epoka e re": Pas deportimit të shtetasve turq kemi pasur reagime të shumta ndaj Turqisë, madje ka pasur edhe protesta para Ambasadës së Turqisë në Prishtinë. Mund të ketë ndonjë tension të raporteve midisi dy vendeve?

Matoshi: Republika e Kosovës dhe Republika e Turqisë kanë marrëdhënie të mira.

"Epoka e re": Z. Matoshi, pas largimit të Listës Serbe prej Qeverisë së Kosovës, si është duke funksionuar kabineti qeveritar? Keni biseduar me ndonjë subjekt politik për t'iu bashkuar koalicionit qeverisës, në mënyrë që Qeveria ta ketë shumicën e nevojshme në Kuvend?

Matoshi: Qeveria Haradinaj është duke i përmbushur agjendat shtetërore sipas mandatit kushtetues. Qeveria nuk negocion me partitë politike për koalicion, rirreshtime etj. Kjo është çështje e partive politike.

"Epoka e re": Mund të kthehet Lista Serbe prapë në Qeveri pas dy shkarkimeve që ndodhën,

meqenëse në një farë mënyre, pas ngjarjeve në veri serbët, kanë kërkuar shkarkimin e kreut të MPB-së?

Matoshi: Lista Serbe besoj se do të veprojë në mënyrë racionale dhe t'i përfaqësojë serbët kosovarë në ekzekutivin e vendit, sepse zyrtarët serbë në qeverisje janë kategori kushtetuese. Ministri Sefaj është shkarkuar për një shkelje kushtetuese.

"Epoka e re": Pas ngjarjeve të fundit, LDK-ja ka kërkuar zgjedhje të parakohshme duke mos përfshirë si alternativë edhe qeverinë teknike. Si i keni parë këto qëndrime të LDK-së?

Matoshi: LDK-ja si parti institucionaliste duhet të bëjë opozitarizëm serioz, duke ushtruar kontroll parlamentar mbi qeverisjen, si dhe të ndikojë në unitet kur janë në pyetje interesat madhore kombëtare të Kosovës, por nuk varet nga ajo jetëgjatësia e Qeverisë së Kosovës. Qeveritë teknike janë groteske. Si mund të funksionojë një Qeveri pa mbështetje politike? LDK-ja, megjithatë, në thelb e ka mbështetur Qeverinë Haradinaj edhe me buxhetin, edhe me ratifikimin e marrëveshjes për demarkimin e kufirit me Malin e Zi, me "Rastin Gjuriq" si dhe në raste të tjera.

Porosia e Ipeshkvit, Imzot Dodë Gjergjit, për Pashkët 2018

Drejtuar priftërinjve, motrave të nderit, besimtarëve dhe të gjithë njerëzve vullnetmirë në Kosovë!

Gjatë përvojës dyzetditore të kreshmëve, jemi përpjekur të hymë në përvojën e popullit të Zotit, që të mund ta shtojmë dashurinë dhe besnikërinë ndaj Zotit tonë Jezu Krishtit. Pastaj, me uratë, meditim dhe agjërime kemi arritur ta zbulojmë praninë e tij në jetët tona. Kurse duke ndarë lëmoshë jemi bërë shërbyes të dashurisë së Zotit në mesin e njerëzve. Tani, kur po festojmë festën e Pashkëve, po kremtojmë triumfin e Krishtit mbi mëkatit dhe botës dhe mbi vdekjen, nëpërmjet Ringjalljes. Ai i gjallë në mesin tonë, vazhdimisht na ngushëllon dhe s'pushon duke na thënë: "Pse po trembeni? Pse po dyshoni në zemrat tuaja? Shikoni duart e mia e këmbët e mia: unë jam!" (Lk 24, 38-39)

Vërtet, Hyji aq fort e deshi botën, sa që dha një të vetmin Birin e vet, kështu që secili që beson në të, të mos birret, por të ketë jetën e pasosur" (Gjn 3,16). Nëpër sakrificën e Krishtit në Kalvar, Hyji, Ati ynë qiellor, ka demonstruar dashurinë e përkryer ndaj bijve që i ka në botë dhe, njëkohësisht, na fton të gjithëve që ta përqafojmë me zemër këtë Dashuri. Ndaj, askush nuk duhet të hezitohet që ta sodisë kryqin dhe të lëshohet në pafundësitë e thellësisë së zemrës, sepse vetëm nga aty mund t'i japim përgjigjen e dashurisë sonë kësaj dashurie Hyjnore, që na u zbulua dhe na u dhurua neve nëpërmjet vdekjes dhe ngjalljes së Jezu Krishtit.

Në festimin e përvjetshëm të Pashkëve, Kisha dhe besimtarët brenda saj, i gëzohen pranisë së Krishtit të Ringjallur në mesin e tyre, bashkë me të kremtojnë,

dëshmojnë dhe e shpallin solemnisht Lajmin e mirë të Ungjillit. Pastaj, ata i ftojnë të gjithë njerëzit që të kthehen te Ati e të besojnë, në mënyrë që të gjithë të jemi në shërbim të dashurisë dhe të paqes mes njerëzve.

"Falë angazhimit të Krishtit, ne mund të jemi pjesë e drejtësisë supreme, e cila shfaqet në dashuri. Kurse, neve na takon të angazhohemi që kjo dashuri, e cila më shumë dhurohet sesa kërkon shpërblim, të ndihet në çdo zemër, të shihet në çdo gjë dhe të jetë e pranishme në çdo vend" (Papa Benedikti i XVI).

Festa e Pashkëve është rast i mirë që ta përtërijmë dashurinë brenda Kishës dhe së bashku me kishën, të angazhohemi që dashuria e vërtetë të arrijë të ndihet në çdo zemër, sepse vetëm atëherë do të dimë të ruajmë gëzimin e jetës. Dashuria e vërtetë nuk mund të jetë një gjest i njëhershëm ose një shprehje e herëpashershme. Dashuria e Krishtit është një gjendje e përhershme që të tjerët e përjetojnë nëpërmjet faljes dhe pajtimit dhe bëhet e prekshme nëpërmjet veprave të tjera të dashurisë. Kudo që gjendet besimtari duhet të bëhet e pranishme dashuria e Krishtit.

Mungesa e dashurisë na ka varfëruar shpirtin dhe po na e bren zemrën. Në një mënyrë, po e bën "të pashijshme" paqen edhe lirinë që po e gëzojmë. Dhe, sa më gjatë po shtyhet koha e konflikteve, aq më tepër po na mungon gëzimi dhe dashuria, si në familje, ashtu edhe në shoqëri. Në vend që të dimë t'u gëzohemi të mirave që kemi arritur, kudo që sillësh, ndien pakënaqësi, zhgënjim dhe mosbesim. Gjithë pëshpëritin diçka kundër njëri-tjetrit, çdokush merr guximin për të vlerësuar ose gjykuar të afërmin; mu ata që s'janë gati t'i nënshtro-



hen së vërtetës, marrin guximin për ta akuzuar tjetrin dhe për ta vlerësuar vetveten. E ata që duhet të jenë shembull, shpeshherë, më shumë bëhen shkandull. Me pakë fjalë, është krijuar një ambient i rëndë, ku ka zënë vend dyshimi, mosbesimi, dëshpërimi dhe konfliktualiteti që po na e zë frymën. Gjithë kjo që po ndodh dhe po e përjetojmë, buron nga mungesa e dashurisë. E, kur njeriu, ndien boshllëkun brenda vetvetes, atëherë këtë vakuum mundohet ta mbushë me kotësi, që në realitet vetëm sa e rrisin zbrazëtinë, gjithnjë e më shumë. Sa ma e zbehtë është dashuria aq ma shumë shpërfaqet vrazhdesia e urrejtjes, që na shtynë kah përçarja dhe konflikti. Konfliktet e brendshme të klasës politike, përplasjet me komunitetin ndërkombëtarë dhe veprimet që provokojnë paqen ose shkelin të drejtat e njeriut, nuk janë gjë tjetër veçse mungesë e dashurisë dhe keqpërdorim i besimit të marrë nga qytetarët.

Shpirti Shenjt i mbushtë zemrat e të gjithëve me dashuri dhe na dhëntë guximin të kthehemi te burimi i dashurisë, që është Krishti i Kryqëzuar dhe i Ringjallur, që të kuptojmë se dashuria nuk është kënaqësi, por dhimbje dhe se dhimbja nuk shërohet me psherëtimë e vajtime, por me qëndresë dhe duresë.

Në festën e paqes dhe pajtimit, mes Zotit e njeriut, kur dashuria e Krishtit të ringjallur ka triumfuar mbi urrejtjen dhe vdekjen, i ftoj të gjithë njerëzit në Kosovë që të gjejnë forcën e dashurisë dhe guximin e faljes dhe pajtimit, në mënyrë që të ecim me gëzim drejt së ardhmes duke i dhënë kuptim të sotmes.

Kjo nuk do të thotë që gjatë ecjes nuk duhet zgjidhur të gjitha vështirësitë që kemi. Ecja pranë njëri-tjetrit dhe përballja me realitetin e bashkudhëtimit është gjithnjë një dialog, nëpërmjet të cilit mund t'i zgjidhim mospajtimet. Kënde, askush nuk duhet

ta shohë dialogun si kërcënim e as kompromiset si dështim, por si mjetin për ruajtjen e paqes dhe si mënyrën për pajtim me të tjerët. Edhe pse kompromisi është pjesë e rëndësishme në dialog, megjithatë nuk duhet harruar që e vërteta dhe sinqeriteti janë shpirti i çdo dialogu.

Duke jua uruar festën e madhe të Pashkëve, uroj që të gjithë njerëzit në Kosovë ta kërkojnë me sinqeritet të vërtetën, ta gjejnë duresën për zgjidhjen e mospajtimeve dhe të mos pushojnë kurrë duke e falur njëri-tjetrin. Sepse, miqësia nuk matet me sa kemi gabuar, por me sa shumë kemi falur. Vetëm kështu do të mund t'i rimbushim me dashuri zemrat, shtëpitë tona dhe gjithë Vendin.

Krishti, Princi i paqes dhe burimi i dashurisë, na ndihmoftë të gjithëve!

Për shumë mot Pashkët!

**+Dodë Gjergji
Ipeshkvi juaj**

Në Kosovë të krishterët festojnë Pashkët

PRISHTINË, 1 PRILL (ER) - Besimtarët e krishterë në Kosovë po festojnë Pashkët. Shumë besimtarë u mbledhën në katedralen "Nënë Tereza" për të qenë pjesë e meshës për festën e Pashkëve. Don Fatmir Koliqi, e cili e udhëhoqi meshën e ditës së Pashkëve, u përcollti besimtarëve urim paqëje dhe shprese.

Urime për festën e Pashkëve kanë dërguar edhe liderët e institucioneve të Kosovës.

Presidenti Hashim Thaçi ka thënë se festat fetare gjithmonë shërbejnë për ta kujtuar faktin që jetojmë në një botë edhe me diversitet besimesh që respektojnë njëri-tjetrin. "Fryma e tolerancës, paqja, solidariteti dhe mirëkuptimi janë vlera të përbashkëta të njerëzimit. Kosova me dinjitet i ka kremtuar dhe do t'i kremtojë fes-

at e të gjithë qytetarëve, pavarësisht prej përkatësisë fetare", ka thënë Thaçi.

Edhe kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, ka uruar të gjithë besimtarët e krishterë për festën e Pashkëve. Veseli ka thënë se kjo festë shënon ditën e ngadhënjimit të jetës mbi vdekjen dhe rikthimin e njeriut të vlerave më sublimë shpirtërore. "Uroj që kjo festë e shpresës, dashurisë e mirëkuptimit t'ju gjejë mes njerëzve tuaj të dashur, me gëzime dhe shumë të mira për juve. Gëzuar për shumë mot!", ka thënë Veseli.

Edhe kryeministri Ramush Haradinaj në urimin e tij ka thënë se shqiptarët kanë traditë mijëvjeçare të Pashkëve. "Kësaj feste që na frymëzon për dashuri dhe që na rrëfen mrekullinë e ringjalljes.



Uroj që kjo festë të na gjejë unikë, të sjellë bekim e begati në çdo

familje. Motra e vëllezër të besimit katolik dhe miq ndërkombë-

tarë, për shumë mot Pashkët!", ka thënë Haradinaj në urimin e tij.

Vetëvendosja: Premtimet e Haradinajt janë të vërteta vetëm më 1 prill

PRISHTINË, 1 PRILL (ER) - Lëvizja Vetëvendosje ka organizuar të dielën aktivitet simbolik me rastin e 1 prillit, "Ditës së gënjeshtrove", si ditë përkujtuese për "trenat e qeveritarëve të Kosovës".

Aktivistja e Vetëvendosjes, Arta Berisha, ka thënë se premtimet e kryeministrit Ramush Haradinaj janë të vërteta vetëm sot, në ditën e rrenave. Sipas saj, Haradinaj është zotuar se brenda tre muajsh qytetarët do të lëvizin pa viza. "Kjo nuk ka ndodhur. Kosova humbi edhe 8 200 hektarë tokë përmes demarkacionit duke i gënjyer qytetarët me liberalizim vizash", është shprehur Berisha. Ajo ka përmendur edhe premtimet e

kryeministrit për formimin e ushtrisë dhe ato për rritjen e pagave dhe pensione. Sipas Berishës, në këtë drejtim nuk u ndërmor asnjë iniciativë në këtë drejtim. "Po ashtu, kryeministri Ramush Haradinaj ka premtuar formimin e ushtrisë së Kosovës. Për shkak të shumë gënjeshtrove, kësaj çështje nuk i erdhi koha për diskutim. Qeveria aktuale nuk ka bërë asnjë iniciativë në këtë drejtim. Sigurisht se edhe rritja e rrogave për 30 përqind dhe pensionet për 25 përqind dhe mirëqenia e qytetarëve janë të vërteta vetëm sot në simboliken e 1 prillit. Urime dita e juaj, kryeministër!", ka thënë aktivistja e LV-së, Arta Berisha.



Pupovci: Sistemi i arsimit në Kosovë, pa përgjegjësi e llogaridhënie

PRISHTINË, 1 PRILL - Drejtuesi i Qendrës për Arsim të Kosovës, Dukagjin Pupovci, ka thënë se në Kosovë nuk është arritur të ndërtohet një sistem i cili reflekton përgjegjësi dhe llogaridhënie. Ai në një intervistë për "Radio Evropa e Lirë" ka thënë se mungesa e përgjegjësisë dhe llogaridhënies ka bërë që Kosova sot të ketë nivel të ulët të cilësisë në arsim dhe të përballlet me probleme të shumta në këtë fushë. "Mendoj se sa i përket periudhës së pasluftës, problemi qëndron në faktin se në Kosovë nuk është arritur të ndërtohet një sistem i cili reflekton përgjegjësi dhe llogaridhënie dhe kjo vërehet në të gjitha nivelet. Mungesa e përgjegjësisë dhe llogaridhënies ka bërë që gjatë gjithë këtyre viteve të mos zbatohen planifikimet. Për shembull, Kosova ka pasur dokumente



strategjike të zhvillimit të arsimit diku nga viti 2002 dhe ato dokumente rregullisht janë përditësuar, mirëpo zbatim i tyre nuk ka qenë i duhuri dhe, edhe më pak ka pasur përgjegjësi për moszbatimin e tyre", është shprehur ai. Pupovci ka theksuar se munge-

sa e cilësisë në arsimin e lartë është identifikuar si problem që nga viti 2004, kur ka ekzistuar vetëm Universiteti i Prishtinës dhe një numër shumë i vogël i institucioneve private të arsimit të lartë. Sipas tij, që atëherë ka qenë një përcaktim, të paktën në letër dhe i aprovuar nga

Qeveria, që të punohet drejt përmirësimit të cilësisë. "Mirëpo, në vend se të punohet në drejtim të përmirësimit të cilësisë, janë hapur edhe dhjetëra institucione private dhe gjashtë institucione të tjera publike të arsimit të lartë, duke sjellë te një masivizim i këtij sektori. E njëjta gjë mund të thuhet për decentralizimin e arsimit, i cili është përfolur shumë nga mesi i dhjetëvjetëshit të parë të këtij shekulli, posaçërisht është zbatuar me Planin e Ahtisaarit, kur Ligji për arsim në komuna ka sjellë një decentralizim të shkallës së lartë. Dhe tani, në vërejmë se në komuna kryesisht punësimet nuk bëhen në bazë të kriterëve të cilësisë, por në bazë të përkatësisë apo lojalitetit politik, partiak dhe kështu me radhë dhe e njëjta gjë ndodh edhe tek emërimet e drejtorëve të shkollave", ka

thënë Pupovci, duke shtuar se e gjithë kjo ka bërë që të kemi një sistem i cili nuk reflekton llogaridhënie dhe kur nuk ka llogaridhënie, nuk mund të ketë as sukses.

I pyetur rreth testit PISA, i cili për herë të dytë pritet të mbahet në Kosovë, Pupovci ka theksuar se nuk pret ndonjë ndryshim të madh. "Nuk pres ndonjë ndryshim të madh për shkak se PISA për nga natyra e vet reflekton aftësinë e nxënësve për t'i zbatuar njohuritë e veta në praktikë dhe sistemi ynë i shkollimit nuk i ka përgatitur fëmijët në masën e duhur që njohuritë që i fitojnë në shkollë, si nga leximi, matematika dhe shkenca, t'i zbatojnë në jetën praktike dhe kjo është arsyeja e dështimit në PISA në vitin 2015, kur Kosova ka marrë pjesë për herë të parë", ka thënë Pupovci.

Thaçi e Haradinaj festojnë Pashkët në shtëpinë e ministrit Lekaj

GIJAKOVË, 1 PRILL (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Pal Leka, me rastin e festës së Pashkëve, ka pritur të dielën në shtëpinë e vet presidentin Hashim Thaçi dhe kryeministrin Ramush Haradinaj. Lekaj përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se nderi, tradita e respekti vëllazëror ndër ne shqiptarët gjithnjë kanë qenë të pamatshëm. "Jo vetëm në

ditë festash si sot, por në secilin moment ne kemi qenë dhe do të jemi bashkë. Faleminderit për sot, nga president z. Thaçi, kryeministër z. Haradinaj dhe nga kolegët partiakë e miq bashkëpunëtorë, për praninë e tyre dhe për nderin që i bënë familjes sonë dhe festës së përbashkët! Urime e gëzuar gjithmonë!", ka shkruar ministri Lekaj.



Flet për "Epokën e re", Ymer Havolli

Trusti ka në menaxhim



Kryetari i Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, Ymer Havolli, ka bërë me dije se trusti me sukses po arrin të përballet me sfidën e ruajtjes dhe rritjes së vlerës së kontributeve pensionale që ka nën menaxhim. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se Trusti ka në menaxhim rreth 1.64 miliard euro. Havolli ka folur edhe për rekomandimet që Komisioni për Buxhet dhe Financa ka dhënë në lidhje me pagat, shtesat dhe kompensimet e tjera të të punësuarve dhe anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

ndesh me legjislacionin apo rregulloret në fuqi", është shprehur Havolli.

Ai u është përgjigjur edhe kritikave të deputetëve për këtë institucion dhe rekomandimeve që Komisioni për Buxhet dhe Financa i ka bërë në lidhje me pagat, shtesat dhe kompensimet e tjera të të punësuarve dhe anëtarëve të Bordit Drejtues të FKPK-së. "Ju njoftojmë se Bordi Drejtues ka formuar një komision ad-hoc i cili nga çdo aspekt, para së gjithash nga aspekti ligjor, strategjik e praktik, do t'i analizojë me kujdes mundësitë, përfitimet dhe pasojat e implementimit të rekomandimeve të Komisionit për Buxhet dhe Financa. Duhet të mos harrojmë e as anashkaluar se sa i përket aspektit profesional dhe ekspertizës brenda Trustit, flasin vetë rezultatet prej 400 milionë eurosh kthim pozitiv prej themelimit të institu-

cionit", është shprehur Havolli.

"Epoka e re": Z. Havolli, sa është aktualisht shuma e mjeteve të cilat i menaxhon Trusti i Kursimeve Pensionale?
Havolli: Deri në fund të shkurtit të këtij viti Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) kishte nën menaxhim rreth 1.64 miliard euro.

"Epoka e re": Sa është numri i kontribuuesve aktivë nga janari deri më tani, dhe si është raporti me vitin e kaluar për këtë periudhë?

Havolli: Më 28 shkurt të këtij viti numri i kontribuuesve aktivë ishte 234 878, ndërsa në të njëjtën datë të një viti më parë ky numër ishte 222 543. Megjithatë, duhet të kihet parasysh se në tremujorin e parë historikisht ka ndodhur që numri i kontribuuesve aktivë të jetë më i ulët sesa në tremujorët vijues. Kjo lidhet kryesisht

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 1 PRILL - Kryetari i Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, Ymer Havolli, ka bërë me dije se numri i kontribuuesve aktivë në këtë fond po rritet. Ai ka treguar se Trusti ka në menaxhim rreth 1.64 miliard euro. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka folur edhe për sfidat me të cilat përballet ky institucion. "Më 28 shkurt të këtij viti numri i kontribuuesve aktivë ishte 234 878,

ndërsa në të njëjtën datë të një viti më parë ky numër ishte 222 543. Megjithatë, duhet të kihet parasysh se në tremujorin e parë historikisht ka ndodhur që numri i kontribuuesve aktivë të jetë më i ulët sesa në tremujorët vijues. Kjo lidhet kryesisht me mënyrën e raportimit që punëdhënësit bëjnë në ATK", ka thënë Havolli. Ai ka deklaruar se sfidë e vazhdueshme e Trustit është ruajtja dhe rritja e vlerës së kontributeve pensionale nën menaxhim.

Havolli ka treguar se deri më tani ky institucion ia ka dalë me

sukses që të përballet me këtë sfidë pasi, sipas tij, vetëm nga viti 2009 e këtej është arritur që rreth 360 milionë euro bruto të kthehen nga investimet. "Sfida të tjera aktualisht Trusti nuk ka, pasi në operimet ditore asnjëherë nuk kemi pasur ndonjë telash a pengesë të pamenaxhueshme. Ky institucion mbikëqyrret rreptë nga Kuvendi i Kosovës, BQK-ja, Auditori i Jashtëm dhe ai i Brendshëm, dhe deri më tani nga këto mbikëqyrje nuk ka pasur gjetje që sinjalizojnë çfarëdo problemi të rënies

rreth 1.64 miliard euro

tik, do t'i analizojë me kujdes mundësitë, përfitimet dhe pasojat e implementimit të rekomandimeve të Komisionit për Buxhet dhe Financa. Duhet mos harruar e as anashkaluar se sa i përket aspektit profesional dhe ekspertizës brenda Trustit flasin vetë rezultatet prej 400 milionë eurosh kthim pozitiv prej themelimit të institucionit.

"Epoka e re": Cilat janë sfidat me të cilat përballet Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës?

Havolli: Sfidë e vazhdueshme e Trustit është ruajtja dhe rritja e vlerës së kontributeve pensionale nën menaxhim, që deri më tani e kemi dëshmuar se ia kemi dalë me sukses, pasi vetëm nga viti 2009 e këtej kemi arritur të kemi rreth 360 milionë euro kthim bruto nga investimet. Sfidat tjerë aktualisht Trusti nuk ka, pasi në operimet ditore asnjëherë nuk kemi pasur ndonjë telashe a pengesë të pamënaxhueshme.

Ky institucion mbikëqyret rreptë nga Kuvendi i Kosovës, BQK-ja, Auditori i Jashtëm dhe ai i Brendshëm. Deri më tani nga këto mbikëqyrje nuk ka pasur gjetje që sinjalizojnë çfarëdo problemi të rënies ndesh me legjislacionin apo rregulloret në fuqi.

"Epoka e re": A ka pasur fitim Trusti nga investimi i mjeteve jashtë vendit këtë vit? Nëse po, sa është kjo shumë?

Havolli: Fillimi i këtij viti është me oscilime të forta dhe vlera e lartë ku tregjet shkuan në fund të vitit 2017 është korrigjuar. Aktualisht jemi në terren negativ (diku -1.3 %) për këtë periudhë të vitit, por kjo nuk është shqetësuese pasi mundësia e rikuperimit dhe ngritjes është e mundshme. Lëvizje të tilla ka njohur në vazhdimësi Trusti, por në nivel viti prej 2009-s asnjëherë nuk e kemi mbyllur negativisht vitin financiar. Pavarësisht prej kësaj, Bordi është duke e ndjekur në baza ditore

gjendjen dhe lëvizjen e tregjeve financiare dhe jemi duke marrë veprime (përmes rialokimit të mjeteve) që t'u përgjigjemi sfidave të mundshme që mund të paraqiten. Sinjalet, e përsëris, aktualisht nuk janë në nivel shqetësues, por po i trajtojmë me kujdes të shtuar. Ky vit, sipas parashikimeve, do të jetë më sfidues dhe më restriktiv për shkak të inflacionit në ShBA dhe normave të interesit që pritet të rriten.

"Epoka e re": A ka pasur investime në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës? Nëse po, në çfarë shume?

Havolli: Po, në fletobligacionet e Kosovës kemi vazhduar t'i rrisim investimet. Në fund të vitit 2017 kishim rekord të investimeve në këtë instrument prej 95 milionë eurosh dhe, përveç tyre, kishim rekord edhe të depozitimit të mjeteve të Trustit në bankat që operojnë në Kosovë, me rreth 50 milionë euro. Pra, asnjëherë Trusti nuk ka pasur investime në Kosovë

dhe shpresojmë se ky nivel të mund të rritet edhe më tej. Gjithsesi nuk guxojmë të harrojmë se Bordi Drejtues është mandatuar që të merret me ruajtjen dhe rritjen e vlerës së mjeteve nën menaxhim e jo për detyra të tjera, andaj vendimmarrja jonë rreth investimeve gjithnjë duhet të jetë e bazuar në parimet e përcaktuara në ligj.

"Epoka e re": Sa është numri i kontributdhënësve që pritet të pensionohen deri në fund të 2018-s?

Havolli: Megjithëse kjo nuk është e mundur të parashikohet saktë, pasi ndikohet nga faktorë të ndryshëm, bazuar në ritmin historik të pensionimit, pritet që numri i të pensionuarve të jetë diku mes 5 e 6 mijë. Në anën tjetër, deri në fund të vitit 2017 nga Trusti kanë përfituar pension 38 512 qytetarë dhe shuma e tërhequr nga këta përfitues ka shkuar në 119.4 milionë euro.

Kriptoalutut për një javë humbin 20 për qind të vlerës

PRISHTINË, 1 PRILL - Vlera e tregut e kriptoalututave ka rënë ndjeshëm në ditët e fundit. Qëkur arriti pikën më të lartë vitin e kaluar, shumica e tyre kanë humbur mes 60 deri në 70 për qind të vlerës, ndërsa vlera e shumës prej këtyre monedhave ndryshon në bazë të trendit të "Bitcoin"-it. Për tregun e kriptoalututave problemet vazhduan edhe në

javën që po lëmë pas, pavarësisht se shpresat që një ditë 'stuhia' të mbarojë nuk janë shuar për entuziastët, kurse të tjerët po shfrytëzojnë çmimet e ulëta për të përfituar, sepse besojnë se ky treg ka për t'u rikthyer. Volumi i tregut ka ngelur i pandryshuar në 5.9 miliardë dollarë në 24 orë. Një rënie poshtë 5 900 dol-

larëve do të ishte lajm i keq për tregun. Aktualisht shumica e kriptoalututave janë në rritje, por në shtatë ditët e fundit kanë qenë në tatëpjetë. "Ethereum" ka rënë në 27.09 për qind apo në 379.69 dollarë. "Ripple" humbi 22.94 për qind apo në 0.49 dollarë. "Bitcoin Cash" ra në 33.03 për qind, ndërsa "Litecoin" në 28.97 për qind apo në 113.24

dollarë. Deri më sot tregu ka qenë në një trend rënie që nga fillimi i këtij viti. Kontratat e shkurtra në "Bitmex" kanë vënë stoqe, shumë më tepër sesa kërkesa. Tregtuesit kërkojnë dyfishimin e fundit. Disa prej tyre po ripozicionohen për të fituar nga një rikthim i papritur i vlerës.



me mënyrën e raportimit që punëdhënësit bëjnë në ATK.

"Epoka e re": Në Kuvendin e Kosovës ka pasur kritika dhe akuza të shumta se Bordi menaxhues i Trustit është joprofesional. Gjithashtu, ka pasur kritika edhe për paga dhe përfitime të shumta për anëtarët e bordeve. Ju si institucion, si qëndroni në këtë aspekt?

Havolli: Bordi Drejtues i Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) ka pranuar shkresën e datës 14 mars 2018, me rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa të lidhje me pagat, shtesat dhe kompensimet e tjera të të punësuarve dhe anëtarëve të Bordit Drejtues të FKPK-së. Ju njoftojmë se Bordi Drejtues ka formuar një komision ad-hoc i cili nga çdo aspekt, para së gjithash nga aspekti ligjor, strategjik e prak-

19 vjet nga masakra Lybeniçit

Përkujtohen të rënët e masakrës së Lybeniçit

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj, kanë përkujtuar të rënët e masakrës së Lybeniçit, në të cilën u patën ekzekutuar mbi 80 persona. Përderisa presidenti Thaçi ka thënë se liria nuk është e plotë pa ndëshkimin e kriminelëve, kryeministri Haradinaj ka theksuar se asnjëherë nuk do t'i harrojnë ata të cilët me jetët e tyre kanë mbrojtur tokën e Kosovës

**EPOKA E RE****Qendresa RAMA**

PEJË, 1 PRILL - Të dielën është shënuar 19-vjetori i masakrës së Lybeniçit të Komunës së Pejës, në të cilën u patën ekzekutuar mbi 80 persona, në mesin e të cilëve ka pasur edhe të mitur. Të rënët në këtë masakër janë përkujtuar të dielën nga dy zyrtarët më të lartë shtetërorë, presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj. Presidenti Thaçi, duke kujtuar të rënët në masakrën e fshatit Lybeniç të Pejës, ka thënë se liria nuk është e plotë pa ndëshkimin e kriminelëve. "Dita e parë e prillit para 19 vjetësh ishte shumë mizore për banorët e Lybeniçit të Pejës dhe gjithë qytetarët tanë. Forcat policore dhe ushtarake serbe, pasi plaçkitën fshatin, vranë dhe masakruan

rreth 80 civilë të pafajshëm: burra, të moshuar, gra e fëmijë", ka thënë Thaçi. Ai ka shtuar se nderimi institucional për të gjithë të rënët do të jetë i përjetshëm. "Liria dhe çdo vlerë e ndërtuar me sakrificë asnjëherë nuk do të jetë e plotë pa ndëshkimin e atyre që i bënë këto krime dhe pa e zbardhur fatin e të gjithë të zhdukurve", ka theksuar Thaçi. Ndërsa kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se asnjëherë nuk do t'i harrojnë qytetarët e Kosovës të cilët me jetët e tyre kanë mbrojtur tokën e këtij vendi. "Sot kujtojmë 19-vjetorin

e masakrës së Lybeniçit, ku u vranë mizorisht mbi 80 civilë të pambrojtur, vetëm pse ëndëronin lirinë e atdheut të tyre. Asnjëherë nuk do t'i harrojmë njerëzit tanë, që me jetët e tyre iu bënë mburojë kësaj toke. Lavdi të gjithë të rënëve për lirinë e Kosovës!", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook". Të rënët në masakrën e Lybeniçit janë përkujtuar edhe nga nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, Xhavit Haliti. Ai ka thënë se familjarët e të rënëve në Lybeniç presin nga drejtësia që të ndëshkohen urdhërdhënësit e këtij krimi. "Viktimat civile

Përfaqësuesit e Lëvizjes Vetëvendosje bëjnë homazhe në Lybeniç

Në përvjetorin e 19 të masakrës së fshatit Lybeniç të Pejës, ku më 1 prill të vitit 1999 ishin ekzekutuar mbi 80 civilë, përfaqësues të Lëvizjes Vetëvendosje kanë bërë homazhe. Delegacioni i LV-së ishte i përbërë nga nënkryetarja dhe deputetja Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, deputeti Ali Lajçi, kryetari i Qendrës së Pejës, Bashkim Lajçi, e shumë aktivistë të tjerë, të cilët kujtuan dhe nderuan viktimat gra, burra e fëmijë të rënë në emër të sakrificës për liri.

shqiptare të Lybeniçit, familjarët e tyre si dhe të gjithë qytetarët e Kosovës, presin me të drejtë që drejtësia t'i ndëshkojë plani-

fikuesit, urdhërdhënësit dhe zbatuesit e gjenocidit serb kundër shqiptarëve të Kosovës", ka deklaruar Haliti.



Së shpejti funksionalizohet lokacioni i deponimit të mbeturinave në Therandë

THERANDË, 1 PRILL (ER) - Kryetari i Komunës së Therandës, Bali Muharremaj, ka bërë me dije se brenda disa ditësh do të funksionalizohet lokacioni në të cilin do të deponohen mbeturinat nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore. Muharremaj ka theksuar të dielën se Komuna e Therandës do të jetë më e pastra në Kosovë. "Lokacioni në të cilin do të deponohen mbeturinat nga

ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore do të funksionalizohet brenda disa ditëve. Deponitë ilegale në komunën tonë jemi zotuar se do t'i eliminonjmë, prandaj po e rregullojmë këtë lokacion që përmes një aksioni të pastrimit ambientit ynë të frymojë më pastër. Premtimin që Komuna e Therandës do të jetë më e pastra në Kosovë do ta realizojmë", ka thënë Muharremaj.

Të drejtat e njeriut sipas Kushtetutës së Kosovës



Shkruan: Jakup KRASNIQI

Kushtetuta jonë mbase mund të ketë shumë mangësi e dobësi por, për sa iu përket të drejtave dhe lirive të njeriut, është në përputhje të plotë me standardet e botës demokratike. Është në përputhje të plotë edhe për sa i përket ndarjes së pushteteve dhe përgjegjësi të tyre edhe në raport me të drejtat e njeriut. Në një situatë të tillë është e domosdoshme të dihet përgjegjësia e secilit pushtet dhe bartësve të përgjegjësive të atyre pushteteve. Pushtetet e Kosovës veç e veç dhe së bashku e kanë për detyrë kushtetuese e ligjore që ta ndriçojnë të vërtetën deri në fund. Të drejtën e shtetasve turq me vendqëndrim në Kosovë dhe të dëbuar (ekstraduar) paligjësisht në Turqi. Atje ku jeta e të dëbuarve është më shumë se e rrezikuar. Për rastin në fjalë, veç të tjerave, janë shkelur të gjitha vlerat tradicionale të

mikpritjes shqiptare. Prandaj, ndriçimi i këtij rasti është domosdoshmëri.

Pse? Sepse bindja ime është se në rastin e rrëmbimit ilegal dhe deportimit të shtetasve turq me leje qëndrimi në Kosovë, është bërë një shkelje zinxhirore e të drejtave kushtetuese e ligjore të njeriut, është shkelur çdo standard i këtyre të drejtave, është bërë shkelja e të drejtave dhe obligimeve të pushteteve të ndryshme kushtetuese, është bërë shkelja e sovranitetit të institucioneve kushtetuese të shtetit dhe vetë sovraniteti i shtetit nga institucioni, që i pari do të duhej ta jepte alarmin (AKI-ja) për dëmin që mund t'i bëhej vendit. Kjo e fundit me kushtetutë ka qenë e obliguar t'i informojë dy instancat më të larta të shtetit, Kryeministrin dhe Presidentin. Nëse nuk janë informuar këto dy instanca, e përsëris, Kryeministri dhe Presidenti, shkelja e Kushtetutës është tepër e rëndë dhe përgjegjësia politike nuk mund të ndalet te dy individë, të cilët kanë përgjegjësi penale të një niveli të lartë. Ndaj përgjegjësia politike, në rastin në fjalë, është edhe atyre që me lehtësi i veshin me përgjegjësi

të nivelit të lartë njerëzit e pandërgjegjshëm, njerëzit që fare nuk e duan shtetin e tyre, por që marrin përgjegjësi vetëm për kusari. Ata që i kanë bërë këto emërime nuk duhet vetëm të skuqen. Ata duhet të kenë moral ta pranojnë përgjegjësinë e tyre edhe nëse është vetëm përgjegjësi morale por, si duket, ata dhe morali janë tepër larg. Në vazhdim le ta shohim se cilat nene të Kushtetutës së Kosovës janë shkelur. Do theksuar se jo vetëm në veprimin e fundit janë shkelur këto nene. Është shkelur neni 2 i Kushtetutës, paragrafi 1 dhe 2. Është vazhduar shkelja e nenit 3, sidomos paragrafi 2. Ka vazhduar shkelja e nenit 4, ku flitet për formën e qeverisjes dhe ndarjen e pushteteve, sidomos paragrafët 4, 5, 6 e 7 të nenit në fjalë. Pastaj neni 7 (vlerat), sidomos paragrafi 1. Në mënyrë më të veçantë janë shkelur liritë e të drejtat themelore të njeriut të parapara në Kapitullin II të Kushtetutës e sidomos nenet 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, etj. Pastaj janë shkelur edhe nenet 53, 54 e 55. Siç po shihet, janë shkelur të gjitha të drejtat e njeriut të përshkruara në nenet e cekura. Sigurisht se ka edhe shkelje të

tjera, por edhe këto që u cekën janë të mjaftueshme që të gjitha institucionet që kanë përgjegjësi kushtetuese e ligjore duhet të veprojnë me përgjegjësi e profesionalizëm. Ndriçimin e kësaj veprë duhet ta fillojnë hetuesia dhe Prokuroria e shtetit për ta përfunduar gjyqësori i vendit. Një gjë është më shumë se e qartë, përgjegjësia nuk është vetëm e atyre individëve që janë apostrofuuar deri më tani, përgjegjësia jo vetëm morale duhet të shtrihet kudo që është ajo. Mediet turke, sipas informacioneve që kanë marrë nga shteti turk, veç të tjerave, po i apostrofojnë edhe Ministrinë e Jashtme dhe atë të Drejtësisë. Nëse është kështu, rasti i kidnapimit të qytetarëve turq me detyra edukativo-arsimore duhet të jenë përgatitur në fshehtësi dhe një kohë të gjatë. Kjo kërkon ndriçim të domosdoshëm e të gjithanshëm. Pasi të ndriçohet ky rast i paprecedentë për botën demokratike, politika jonë duhet të ketë vullnetin e përbashkët për të gjetur rrugën e duhur për të ecur tutje, krejt ndryshe nga kjo e deritashmja. Nuk mendoj që duhet të shkojmë me nguti në zgjedhje të

reja, e aq më pak me kërkesën e atyre që duhet ta ndiejnë një përgjegjësi për një zgjedhje të bërë në legjislaturën e kaluar, një zgjedhje më shumë sesa të gabuar. Për atë zgjedhje që ata e bënë atëherë me votat e tyre, qytetarëve të Kosovës duhet që t'ju kërkojnë falje publikisht. Është e qartë, ndryshimi vetëm në qeveri, edhe po të ndodhte nuk është zgjidhja e problemit! E shoh si të domosdoshme që në shoqërinë tonë të fillojë një debat përmbytësor që i mbyll njëherë e mirë këto skandale të përsëritshme, së paku, ato që kanë ndodhur nga 20 dhjetori i vitit 2017 dhe vendit t'i jepet një drejtum i ri edhe në përmbajtje. Përndryshe, këto gjëra që po ndodhin në vendin tonë nuk janë vetëm defekte, se defekte ka në çdo shoqëri të organizuar! Jo, këto veprime nuk janë defekte. Janë veprime mirë të organizuara, të planifikuara e të përfunduara. Janë veprime të turpshme dhe rrënuese për shtetin. Vepra, as më shumë e as më pak, është krim i organizuar dhe shkelje e rëndë e Kushtetutës. Quani si të doni, ndaqi "defekt", ndaqi "rast të izoluar". Pasojat do të jenë afatgjata, por duhet të punojmë shumë në përmirësimin e tyre.

Gladiatorët e UÇK-së po i kënaqin spektatorët anti-UÇK



Ismail SYLA

Është shumë i dëmshëm koncepti, sipas të cilit, nuk mund të jesh kontribuues i luftës çlirimtare dhe i çlirimit të atdheut nëse nuk ke vdekur, nëse nuk je vvarë, nëse nuk je dëshmor ose në qoftë se nuk je pjesëtar i familjes së dëshmorëve. Çlirimi i atdheut është vepër

vigane e ideve, vizionit dhe ndjenjave e sakrificës dhe rënies për qëllime madhore. Realizimi i këtyre qëllimeve nuk i vë kundër njëri-tjetrit aktorët e gjallë me ata që janë sakrifikuar. Kontributi për atdheun nuk matet me peshën e kilogramëve të armëve, por me faktin se kundër kujt janë drejtuar ato armë. Lufta çlirimtare është një tërësi organizimi e përpjekjeje në të cilën kontributi politik, ushtarak, logjistik dhe ai prapavijës janë të lidhur organikisht. Jemi dëshmitar të disa deklaratave të mëhershme, por edhe aktuale lidhur me kontestimin e kontributit të njërit për tjetrin të figurave të larta të UÇK-

së. Kur këto tunda - mendje (kontestime) bëhen për inate personale, ato tejkalojnë natyrën e tyre, kur i hidhen publikut të gjerë. Në radhë të parë ato po gërryejnë si acidi mbi metal shtresën mbrojtëse, të armuar të personaliteteve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Madje, duke u thelluar, ato edhe më shumë po i shërbejnë spektatorit me prirje të natyrsme anti-UÇK. Sipas kësaj mendësie vetë rrënuese askush nuk ka qenë sa duhet komandant, asnjëri nuk ka qenë sa duhet trim dhe i guximshëm, askush nuk ka qëndruar sa duhet në front, askush nuk ka luftuar sa duhet drejtpërdrejt me

forcat ushtarake dhe policore serbe, askush nuk ka sa duhet histori betejash e përlëshjesh me Serbinë, askush nuk ka qëndruar sa duhet brenda në Kosovë. E për të qenë komandant dhe drejtues i UÇK-së, qenkësh dashur të rrih vetëm në front, vetëm në përlëshje, vetëm në beteja dhe assesit të mbetesh gjallë, por gjithsesi të vritesh heroikisht. Aq më keq, këto deklaratat kanë krijuar efektin e "rrethit veskeq". Flet i pari që provokon të dytin, i dyti i përgjigjet të parit, duke përmendur një të tretë. E kështu me radhë. Duke bërë garë se kush t'ia nxjerr në pah dobësitë tjetrit, duke ia djegur cejzin njëri tjetrit, ata në këtë mënyrë po nxijnë atë

rreth aureole, që tjerët nga jashtë nuk do të mund t'ua errësonin asnjëherë. Një deputet që kërkoi në mënyrë emocionale përkrahjen e deputetëve kryeneçë shqiptarë për votimin e demarkacionit u shpreh me naivitet se ata është mirë të votojnë për inat të listës serbe, që t'ua "plasin zemrën". Në fakt, këto deklaratat, në të kundërtën, po ua kënaqin zemrën spektatorëve me prirje natyrore kundër liderëve të UÇK-së. Dhe kjo nuk është më betejë e rëndomtë. Është betejë gladiatorësh.

(Pikëpamjet në këtë shkrim janë personale)

Temperaturat do të ngrehen deri në 20 gradë celsius

PRISHTINË, 1 PRILL (ER) - Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK) ka njoftuar se gjatë pesë ditëve të ardhshme temperaturat maksimale në vendin tonë do të lëvizin nga 12 deri 20 gradë celsius. "Do të mbajë mot me diell dhe

pjesërisht i vranët. Kjo gjendje stabile e motit do të mbretërojë si rezultat i masave të ngrohja të ajrit me origjinë nga Afrika Veriore. Temperaturat minimale do të lëvizin ndërmjet 3-6 gradë celsius, ndërsa maksimalet e ditës për këtë

periudhë të parashikimit parashihet të lëvizin ndërmjet 12-20 gradë celsius. Dita e mërkurë parashihet t'i shënojë vlerat e temperaturave maksimale, ndërsa të premtën do të shënohen temperaturat më të ulëta", është thënë në njoftimin e IHMK-së. Sipas këtij instituti, shtypja atmosferike do të shënojë ngritje graduale, pasi do të fryjë erë kryesisht nga juglindja deri të enjten me shpejtësi deri 6m/s, derisa ditën e premte parashihet një destabilizim i përkohshëm i

timin e IHMK-së. Sipas këtij instituti, shtypja atmosferike do të shënojë ngritje graduale, pasi do të fryjë erë kryesisht nga juglindja deri të enjten me shpejtësi deri 6m/s, derisa ditën e premte parashihet një destabilizim i përkohshëm i



motit, duke krijuar kushte për rënie të temperaturave dhe reshje shiu.

Gjermania: Dialogu me Rusinë është i mundshëm

BERLIN, 1 PRILL - Ministri i Jashtëm gjerman ka thënë se pavarësisht humbjes së besimit në Rusinë, shteti i tij është i gatshëm ta vazhdojë dialogun me Moskën, në përpjekje për t'i zgjidhur konfliktet rajonale. "Nuk ka diskutim. Besimi është humbur për shkak të veprimeve të Rusisë në vitet e fundit", ka thënë Heiko Maas në një intervistë të publikuar në

gazetën gjermane "Bild am Sonntag". "Në të njëjtën kohë, ne na nevojitet Rusia si partnere, për shembull për të ndihmuar në zgjidhjen e konflikteve rajonale, për çarmatim dhe më e rëndësishmja si një shtyllë e rendit multilateral", ka thënë ai. "Prandaj, ne jemi të hapur për dialog pikërisht për këto arsye dhe shpresojmë ta rindërtojmë besimin hap pas

hapi, nëse Rusia është e përkushtuar për një gjë të tillë", ka shtuar Maas.

Gjermania u është bashkuar aleatëve perëndimorë në dëbimin masiv të diplomatëve rusë për shkak të dyshimeve se Moska qëndron prapa sulmit me agent nervor ndaj ish-spiunit rus Sergei Skripal dhe vajzës së tij Yulia në Britani.



Marrëdhëniet Rusi - Maqedoni, jo të mira

MOSKË, 1 PRILL - Urdhri për dëbimin e një diplomati rus nga Maqedonia ka nxjerrë një retorikë kërcënuese nga Federata Ruse ndaj vendit të vogël ballkanik, ndërkohë që Shkupi me tone të matura përpjehet t'i ulë tensionet.

Diplomati rus, emri i të cilit nuk u bë i ditur, përveçse u dëbua në shenjë solidarizimi me Britaninë e Madhe për rastin "Skripal", merrej edhe me veprimtari spionazhi, sipas Ministrisë së Jashtme maqedonase.

Ambasadori rus në Shkup Oleg Shçerbak, duke shprehur qendrimit e Moskës kundër anëtarësimit të mundshëm të Maqedonisë në NATO, tha se vendi i tij, në rast të një konflikti me aleancën veriatlantike, nuk

do ta përjashtonte Maqedoninë si cak i sulmeve eventuale ruse. Autoritetet maqedonase përpjehen t'i mënjanojnë retorikat e ashpra dhe as nuk dihet nëse do ta thërrasin për shpjegim ambasadorin Shçerbak.

Kryeministri maqedonas Zoran Zaev shpreson se Rusia dhe Maqedonia do të ndërtojnë miqësi midis tyre dhe jo të thellojnë përplasjet verbale, por thotë se Konventa e Vjenës është shumë e rëndësishme dhe e saktë dhe ligjet e Maqedonisë po ashtu. "Ne kemi vepruar vetëm mbi bazë të Konventës së Vjenës dhe ligjeve të Maqedonisë, ndërkohë që disa herë u është tërhequr vërejtja përfaqësuesve diplomatikë rusë në Maqedoni që të mos veprojnë jashtë këtyre



kornizave", thotë ai.

Maqedonia, tha kryeministri Zaev, ka synime strategjike dhe ato janë anëtarësimi fuqiptotë në NATO dhe në Bashkimin Evropian. Por, ne, shtoi ai, nuk kërkojmë anëtarësim në NATO

që të sulmojmë dikë, por që të kujdesemi për paqen në botë së bashku me vendet e aleancës. Ne e kërkojmë këtë për shkak të vlerave të NATO-s dhe sundimit të ligjit, vlerat që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, lirinë e

fjalës, që janë vlera të NATO-s dhe BE-së dhe këto janë arsye të Maqedonisë janë orientuar kah këto organizata, u tha Zaevi mjeteve të informimit.

Ai përsëriti se dëshiron përmirësimin e marrëdhënieve me Federatën Ruse për çka tha se të dy vendet mund të kenë dobi dhe, siç u shpreh, në Maqedoni ka një shumicë dërrmuese të ortodoksëve-sllavë si edhe në Rusi që paraqet një lidhshmëri në mes tyre.

Përpjekjet për shtrirjen e ndikimit rus nga ana tjetër, sipas analistëve, nuk mund të rezultojnë me sukses në Maqedoni për shkak të përcaktimit të popullit të këtij vendi drejt integriteteve euroatlantike.

ShBA-ja bllokoi mocionin për hetime mbi Izraelin

NYU JORK, 1 PRILL - Shtetet e Bashkuara kanë bllokuar një mocion të Këshillit të Sigurimit për hapjen e hetimeve lidhur me përdorimin e municionit luftarak kundër palestinezëve që po merrnin pjesë në një protestë masive në Rripin e Gazës. Njoftimin e bëri Agjencia Franceze e Lajmeve, bazuar në pohimet e një diplomati në Këshillin e Sigurimit. Të shtunën dy palestinezë u qëlluan në këmbë nga ushtarë izraelitë ndërkohë që po ecnin pranë barrierës në Rripin e Gazës që ndan Izraelin nga palestinezët.

Në një tjetër incident një 16-vjeçar u plagos në të dyja këmbët nga forcat izraelite kur ai dhe një djalë tjetër po hidhnin gurë me llastikë në drejtim të barrierës prej gardhi. Autoritetet palestineze thonë se ushtarë izraelitë vranë të paktën 15 veta të premtën dhe mbi 750 të tjerë u qëlluan me municion



luftarak.

Palestinezët mbajtën një ditë zie të shtunën, të shoqëruar me thirrjet për "shpagim". Kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu përgëzoi forcat izraelite që kishin qëlluar mbi palestinezët. Ushtria izraelite tha përmes një deklaratë se 10 nga palestinezët e vrarë kishin lidhje me grupe terroriste dhe ishin qëlluar derisa kryenin akte terrori.

Erdogani dhe Netanyahu shkëmbejnë akuza për protestën në Gaza

ANKARA, 1 PRILL - President turk Rexhep Tajip Erdogan e ka akuzuar kryeministrin izraelit Benjamin Netanyahu se është "terrorist", pasi ky i fundit kishte thënë se komentet e Ankarasë mbi protestat vdekjeprurëse janë "leksione për moral". "Netanyahu, ti je okupator dhe si një okupator ti i ke ato territore. Në të njëjtën kohë, ti je terrorist", ka thënë Erdogan gjatë një fjalimi në Adana, transmeton AFP. "Ajo çfarë ti bën për t'i shtypur palestinezët, do të jetë pjesë e historisë dhe ne nuk do ta harrojmë kurrë", ka thënë Erdogan, duke shtuar se "populli izraelit nuk ndihet mirë me atë që ti bën".

Këto komente të Erdoganit vijnë pasi 15 palestinezë u vranë dhe qindra të tjerë u plagosën në përleshje me forcat izraelite



gjatë protestës të së premtes, në kufirin mes Izraelit dhe Rripit të Gazës. "Ushtria më e moralshme në botë nuk do të pranojë mësim për moralin nga dikush që për vite të tëra ka bombarduar civilët", ka shkruar në "Twitter" kryeministri izraelit, Benjamin Netanyahu.

Papa mban Meshën e Pashkëve në Vatikan

VATIKAN, 1 PRILL - Papa Françesku kremtoi në Bazilikën e Shën Pjetrit shërbesat solemne me rastin e Pashkëve katolike. Ati i Shenjtë u bëri thirrje katolikëve të mos qëndrojnë në heshtje përballë padrejtësive që shohin përreth tyre. Të shtunën në mbrëmje

Ati i Shenjtë drejtoi shërbesat fetare natën para Pashkëve, që përfaqësojë momentin më të shenjtë të kalendarit katolik. Papa pagëzoi tetë individë, ndër ta një lypës nigerian i cili ka marrë famë në Itali pasi u përlesh me një plaçkitës pa pasur vetë armë.

Papa nxiti pasuesit e tij të dalin nga rutina dhe t'i përqafojnë mësimet e Zotit. Të dielën papa mbajti meshën me bekime e mesazhe për paqe drejtuar besimtarëve të mbledhur në Sheshin e "Shën Pjetrit" në Romë.



Për shënimin e 140-vjetorit të dëbimit të shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit 1877/78 (2)

JETON AJO KULTURË QË VLERËSOHET

Prof. dr. Drita
HALIMI-STATOVCI

Në aspektin e klasifikimit tipologjik veshja popullore e këtyre trojeve i takon tipit të veshjes me tirq për burra, ndërsa për gra ka dy tipa: tipi i veshjes me këmishë të gjatë e dy mbështjallakë dhe tipi i veshjes me dimi (fillimisht dimi të leshta të quajtura me gurra, për të vazhduar me dimi të materialit të fabrikuar). Gjithashtu dëshiroj të theksoj se gruaja është ruajtëse më e mirë e traditës, por edhe transmetuesja dhe pranuesja më e mirë e të resë e modernes. Së këndejmi, këtu bëhet fjalë për veshjen, të cilën te pjesëtarët e pasardhësve të Sanxhakut të Nishit, gruaja e ruajti deri më sot. Natyrisht këtu do të shtroj vetëm diçka të domosdoshme për temën tonë bosht. Për të dy gjinitë, për meshkuj e për femra, veshja ka strukturë të plotë, është e ndërtuar me material të prodhimit shtëpiak, ka emërtime kostumore të bukura shqiptare, ka ngjyrë të lashtësisë e të kohës moderne, ka dekor të mrekullueshëm të bukur, por edhe simbolikë. Veshja e femrave është posaçërisht e pasur me shumë dekor, madje edhe amuletik, i cili si ansambël i plotë i jep femrës një graciozitet të theksuar dhe krijon marrëdhënie të veçantë bukurie dhe stoicizmi të bartëses e të tjetrit përballë saj. Kjo veçanërisht për statusin shoqëror e pozitën nuse dhe grua e re. Duhet shtuar se veshja me këmishë të gjatë e dy mbështjallakë kishte dalë prej përdorimit aktiv të përditshëm që herët, diku në fund të shek. XIX e fillim të shek. XX. Filozofia tregimtare e pasardhësve të popullatës nga Sanxhaku i Nishit, apo historia orale, që teorikisht mund të flitet edhe për raportin ndërveprues antropologji dhe histori¹, e këtyre banorëve, që sot jetojnë në vendbanime të ndryshme të Republikës së Kosovës, në aspektin kohë shtrijnë mbamendjen përtej shekujve të jetës së vet, duke përfshirë edhe gjysmën e dytë të shek. XIX. Në aspektin artefaktual, një histori e shkurtër orale e këtyre banorëve zbulon arkaizma në pjesë të veçanta kostumore, zbulon funksionalitet të veshjes në jetën aktive të përditshëm, por zbulon edhe artefakte kostumore, që kanë humbur aktualitetin e përditshëm, por që kanë fituar statusin sakral, që kanë kaluar të jetojnë si pjesë e dokeve dhe zakoneve të tyre, të traditës pra. Gjatë hulumtimeve në terren, kudo në Kosovë, mësova se tipi i veshjes me këmishë të gjatë, që fillimisht ishte e pëlhurës së vequr, për vajzën që bëhet nuse -marto-



Shembull "rehabilitimi romantik" në veshjen e Anamedvegjës - jo që ripërtëritet punesa e dorës, por me krenari i shënohet edhe viti i prodhimit të artefaktit

het pra, ka një funksion sakraliteti. Rastis që edhe në ditët e sotme, si vlerësim për të kaluarën, të praktikohen rituale dasmore dhe këmisha e gjatë tok me mbështjellakun e pasëm huazohet nga ndonjë grua, që këto pjesë kostumore i ruan si kujtim të traditës, përkatësisht si një testament të së kaluarës dhe pikërisht për ta zbatuar traditën e lashtë. Ndërsa mbështjellaku i parmë, të cilin e quajnë përparc nuk huazohet, meqë nuk ka nevojë, sepse edhe në kohën e re përparcin e bukur e ruan gati çdo shtëpi, madje mbahet i njëjtë edhe në tipin e veshjes me dimi. Në të vërtetë, këtu kemi të bëjmë me një segment ritualistik, i cili një pjesë kostumore sot e standardizoi në doke, në zakon, në traditë. Këmisha e bardhë, e gjatë deri në fund të këmbëve, e pëlhurës së vequr ose të fabrikuar, si dhe mbështjellaku i leshtë i pasmi, i punuar ekskluzivisht në vegje, i materialitetit shtëpiak pra, që moti nuk mbahen në përditshëm, por kanë kaluar në një lloje jete të dytë, në ate dokësore sakrale. Nga ky këndvështrim do të pajtohesh me autorin Halbwachs², kur thotë se memoria kulturore shfaqet reflektive në tri mënyra, fjala vjen edhe kur interpreton ritualet e së kaluarës. Këmisha e gjatë e plotësuar me dy mbështjellakë e pjesë të tjera kostumore, me dekor të pasur vishet vetëm ditën e tretë të vajit ritualistik të vajzës që martohet, por edhe të femrës në statusin nuse dhe grua e re. Sipas teorive antropologjike dhe autorit Chapman,³ shikuar në kultura të ndryshme njerëzore, jo që dukuria e këtyre reflekton nivel të lartë artistik të veshjes së zgjedhur, por reflekton edhe "rehabilitim romantik" të veshjes popullore, si dhe kulturë memorizuese reflek-

sive. Është e habitshme, por këtu kemi të bëjmë me një lloj sakralizimi të një tipi të dalluar të veshjes popullore, që ruhet me shumë kujdes dhe huazohet e praktikohet vetëm për të ushtruar një zakon, një ritualitet martesor.⁴ Ja pra edhe një mënyrë e veçantë e vlerësimit dhe e ruajtjes, e memorizimit të traditës pas kaq kohe të gjatë, dhe pas kaq shumë dhembjeve shpirtërore e humbjeve materiale. Pa dashur të elaboroj më gjerësisht, të shtoj se sipas një teorie të A. Warburgut⁵ energjia mnemonike objektivizon kulturën jo vetëm me punën e artit të bukur, por edhe nepërmjet posterëve, kostumeve, zakoneve e të ngjashme. Rrethanat jonjerëzore në një interval të caktuar kohor e mori shpirtin e njeriut, e mori jetën e tij, por ja se nuk arriti ta shfarosë shpirtëroren në njeriun. Po këta

njerëz të këtyre trojeve, përkatësisht pasardhësit e tyre e ruajtën memoriën, kujtesën, e rindërtuan atë që njihet si kulturë materiale, mbajtën fort në kujtesë dhe zbatuan kulturën shpirtërore. Pra, kultura jeton, ashtu si njeriu e vlerëson, e performon dhe e transmeton! Shembuj kur fenomenet kulturore veprojnë mbi ndërgjegjen njerëzore, të këtyre ose të ngjashëm janë të pafund, por duhet pasur aftësi që këto të hetohen, të përjetohen e të ndriçohen shkencërisht. Si komponent bazë që ndërton traditën dhe tërësinë etnike është edhe territori, trangu i përbashkët, ku jeton dhe vepron një etni dhe një komb. Nuk e shoh të nevojshme të flas këtu për trangu etnik shqiptar, ku jetuan e jetojnë edhe pjesëtarët e sanxhakut të Nishit, për gjeografishtrirjen e këtij trangu, për dy shtete shqiptare - Shqipëri

e Kosovë dhe për kufizimet e këtyre me shtete politikisht të definuara për rreth kufijve në të katër anët e pa vullnetin e tyre, duke u prekur gjithnjë me hapësira të trangu të copëtuar shqiptar dhe me popullatë shqiptare, që vazhdon të jetojë i palëkundur në trojet e veta edhe në kohën e sotme. Kufijt administrativë, shtetërorë e politik nuk e kufizojnë, nuk mund ta ndajnë kulturën, traditën dhe trashëgiminë kulturore, nuk mund ta ndajnë shpirtëroren e njeriut. Teorikisht është e njohur se kultura ka rrugën e vet, ajo rron, transmetohet ndër breza dhe begatohet, gjithnjë duke mbajtur kontinuitetin dhe originalitetin e vet, përkundër faktit se gjatë rrugës historike ka edhe konkurrentë. Roli dhe fuqia e traditës janë të pazëvendësueshme e të pa konkurrencë! Megjithatë, duhet pranuar se në kohën globaliste është thuaja e pamundur të ruhet originaliteti në traditë. E bukura është se tradita edhe kur riprodhohet, kur dialogohet dhe kur pretendohet si origjinale dhe si traditë popullore, ajo gjithnjë përcjell mesazhe dhe zgjon senzualitet. (Fund)

¹ Historical Anthropology and its Futures, ed. By Brian Keith Axel, Duke University Press, London 2002 në disa vende.

² M. Halbwachs, The Collective Memory ..., f. 132

³ M. Chapman, "Frazing the Frame", Dress and Ethnicity in Britany and Gaelic Scotland, në: Dress and Ethnicity, ed. Ba. J.B. Eicher, Berg publishers 1995, f. 8.

⁴ D. Halimi-Statovci, Veshjet shqiptare të Kosovës, IAP, Prishtinë 2009, f.286-305.

⁵ Sipas: J. Assman and J. Czaplicka, New German Critique..., f. 129



Mbështjellaku i leshtë me pala, që sot jeton në rituale dokësore si një sakralitet

Folklori, mbrojtës i identitetit dhe kulturës shqiptare

(Mustafa Ibrahim, "Proza gojore shqiptare nga trevat e Prilepit dhe Krushevës". Interlingua, Shkup, 2017, f. 207)



Mr. Kosovare KRASNIQI

Një kohë të gjatë prof. dr. Mustafa Ibrahim në opinionin akademik paraqitet me tekste të shumta shkencore, kryesisht nga fusha e gjuhësisë dhe sociolinguistikës, por nuk është befasi të na paraqitet edhe me vepra nga fusha e folklorit, siç ndodh me librin në fjalë. Dalja në dritë e librit "Proza gojore shqiptare nga trevat e Prilepit dhe Krushevës (2017)" jo vetëm se e pasuron folkloristikën shqiptare, por na sjell një material folklorik nga një trevë të skajshme të vendbanimeve shqiptare. Vlen të theksohet se ky është libri i dytë i autorit me materiale folklorike, kurse libri i parë titullohej "Thesari folklorik nga rajoni i Pelagonisë (2003)" dhe kryesisht përmban lloje të ndryshme të këngëve popullore të kësaj treve. Këta libra kanë një peshë të veçantë sepse në njëfarë mënyre proza dhe lirika kompletohen midis vete dhe paraqesin tërë thesarin e krijimtarisë gojore të kësaj ane të izoluar dhe të skajshme shqiptare.

Kur autori më besoi të isha pjesë e librit të tij, e kisha vështirë të pranoj, por nga pozita e recensuesit më lejohet të shpreh opinionet e mia mbi peshën që mban kjo vepër e munguar për folkloristikën shqiptare të këtij rajoni, por edhe studimet albanologjike në përgjithësi. Ajo që si kritike letrare më le përshtypje është interesi i autorit për gjuhën dhe traditën materiale dhe shpirtërore, si thesar i çmuar i një populli. Autori me këto dy libra dëshmon se rrjedha e historisë, gjuhës dhe kulturës shqiptare vazhdon të ecë me hapa të sigurt dhe me këto dëshmi lehtë mund të përcillet brez pas brezi. Këtë entuziazëm kaq të madh sigurisht ia ka mundësuar dashuria jo vetëm për traditën, zakonet, doket, lojërat etj. por për ta mbledhur dhe njohur edhe më leksikun e pasur gojor dhe karakteristikat e kësaj të folmeje.

Ky portretizim i prozës gojore të Prilepit dhe Krushevës me epitelin "thesar i paçmuar" nuk është i rastit sepse shumë nga këto zhanre, si: mesele, përralla, temsile (kallëzime), legjenda, lojëra popullore etj. nuk përdoren më, po zhduken dhe harrohen. Autori Ibrahim i lidhur me botën e rrëfenjave të vendasve të tij, pasurinë shpirtërore të trashëguar brez pas brezi dhe për të na njohur dhe gjuhën e paraardhësve të tij, arriti që mundin shumëvjeçar për mbledhjen e tyre në një libër të vetëm, ta realizonte në vitin 2017 me titull: "Proza Gojore shqiptare nga trevat e Prilepit dhe Krushevës", që shtrihet në 207 faqe. Libri është organizuar në 10 kapituj, duke i paraqitur me numër rendor rrëfimet e ndryshme. Përbëhet nga këto pjesë: Hyrje, I. Libri përveç përmbajtjes dhe parathënies, përmban edhe kapituj, si: Përralla, temsile (kallëzime), legjenda, anekdota, ngjarje historike, lojëra popullore, fjalë të urta dhe fraleogjizma, gjëegjëza, besëtytni, dhe në fund autori na flet për karakteristikat të cilat e veçojnë të folmen e Prilepit dhe Krushevës.

Vëllimit i prin një hyrje sintetike, në të cilën autori sjell disa nga arsyet, pse kërkimet në fushën e folklorit, përkatësisht prozës gojore janë të rëndësishme jo vetëm për folklorin dhe brenda saj prozën gojore, por edhe për disa nga përbërësit e tjerë historik dhe etnik të popullit, që e përdor dhe e ruan këtë pasuri mbarëkombëtare. Deri më tani nuk kemi pas ndonjë studim të prozës gojore të kësaj treve, përveç një studimi për lirikën gojore në vitin 2003", pra, ai del sikur një "akullthyes" i cili vazhdon të gërmoj në gjurmët e gjuhës së të parëve të tij. Historia, gjuha dhe jeta e gjallë në vendbanimet shqiptare të trevës së Prilepit dhe Krushevës, e bëri autorin që përveç shpirtërisht, kësaj treve t'i përkushtohet edhe intelektualisht.

Ndërkaq në kapitullin e parë "Përralla" autori na paraqet 15 përralla në të folmen origjinale të vendasve. Përrallat siç e dimë janë gojëdhëna të cilat janë bartur brez pas brezi, por që pothuajse me të njëjtën intensitet vazhdojnë edhe tash të mblidhen, por në mënyrën e të shkruarit dhe të botuarit.

Duke u mbështetur në motive dhe subjektet e tyre, përrallat përmbajnë tema patriotike, sociale, folklorike e mitologjike të vjetra disa shekuj, por të trashëguara brez pas brezi.

Duke e ditur se letërsia ndërtohet me anë të gjuhës, autori Ibrahim na jep edhe letërsi nga pozita e një gjuhëtari. Duke futur edhe kapitullin e përrallës këtu, na jep të kuptojmë që edhe pse rrëfimet e përrallës kanë në brendësi të kaluarën e largët, në subjektin e tyre shpaloset një realitet i cili edhe sot e kësaj dite ende është aktual. Përralla "Kush punon an" si temë qendrore ka përshkrimin e pasojave që sjell përtacia. Nusja e sapomartuar, një vajzë e lazduar në shtëpinë e të atit, mendon që edhe në shtëpinë e burrit, vazhdohet me të njëjtat avaze.

- Mas dasmes\ të gjith njerëzit u rroken për paunet e përditshme qish i kishin\ Erdhi dreka\ vjeri i shpajs e dajti buken\ për të gjith njerëzit qish kishin punau\ sallde Anaifes nauk i dha\ vjera tha\ nauses buk\ vjeri tha\ Anaifes nuk i ajet buk\ Erdhi dreka\ nis oj gjajti\ ene per dark Anifes nauk i dhan buke\ (27).

Populli si autor i shumë rrëfimeve nga më të ndryshmet, gjithnjë përrallave u ka gjetur një përfundim sa më origjinal më bindës dhe me një fund të lumtur. Andaj edhe në këtë rast në përrallë është dhënë një fund i lumtur sepse vajza përtace, bëhet nusja më e zonja kur e kupton që pa punuar s'ka edhe çfarë të hajë. Dhe duke iu përmbajtur kriterëve të gjuhës, gjuha e përdoruar në librin e Mustafa Ibrahimit del e natyrshme tek personazhet e përrallës, ashtu sikurse sikur se ishte në të vërtetë rrëfimi oral tek populli i kësaj treve. - "Të nesërmen Anaifja u qujt ernet\ i moli lopet\ u dha uj\ e mshaini oborin\ ene gatayti buk për dreka\ kaur erdhi dreka\ vjeri anaifes ja dajti copen ma t'madhe t'bukes\ (27). Po e njëjta përrallë, e cila është në libër, tregohet edhe në pjesët tjera shqiptare, si mund të marrim shembull, tek ne, në Kosovë, por me një variant tjetër të gjuhës.

Në kreun III janë temsilet (kallëzimet) me gjithsej 15 kallëzime që janë mbledhur nga goja e popullit të këtij rajoni. Veçori konkrete e librit

është përdorimi i gjuhës, të folmes së popullit duke lënë anash shumë gjuhën letrare shqipe të njehsuar. Autori e bën me vetëdije këtë sepse njeriun dhe realitetin shqiptar të trevës së tij e parqet pikërisht përmes gjuhës, folklorit dhe problemeve të tij që has në jetë.

Subjekti i anekdotave të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të librit 80 anekdota, janë ato të cilat duke e studiuar më afër vëren se brenda subjektit të tyre konkretizohet natyra e njeriut, psikologjia e tij, mentaliteti, kultura, botëkuptimi e temperamenti. Mënyra e thurjes së tyre në libër është e shkruar ashtu sikur është dalë nga gjuha e popullit të kësaj treve dhe nuk është ndërruar asgjë nga ritmi i rrëfimit të pleqve.

Nj'onin e kan payt:

Pi kujt ke frak ma shaum ,pi ati qish i ke najat apo pi ati qis si ke najat?

Ky thot:-Nauk kaum gajle pi kti ci asni t'majr nauk im kum bomen, po pi ati qish i kum najft!(76)

Dhe më tej:

Fjalë të urta:

"As per kish, as per xhamai", "bom bab, tët gjaj", "qish ka nzemer, diften"

Në këtë hapësirë gjeografike, studiuesi Ibrahim punoi për dy dekada me radhë, mirëpo, i vëmendshëm dhe i ndjeshëm gjatë ecurisë së tij të punës, edhe në vitet që pasuan ai do të vijoj punën e tij studiuese, ndonëse, vërehet se prozat gojore, janë të mbledhura me intervale kohore prej 24 vitesh (1993-2017).

Nga regjistrimi i legjendave, përrallave, anekdotave, fjalëve të urta, tregimeve historike vërejmë se autori i gjurmon, i qartëson dhe e përshkruan në librin e tij, nuk gaboj kur them se ai ndoqi një rrugë të drejtë me kriter shkencore kur interesat e tij shtrihen edhe në fushën e studimit të folklorit sepse siç thotë edhe vet autori i librit: "konsiderojmë se ky studim nga jeta materiale dhe shpirtërore e popullatës së këtij rajoni do të jetë mjaft i dobishëm për folklorin shqiptarë, si edhe etnolinguistikën, leksikologjinë, dialektologjinë, interferencën gjuhësore, dygjuhësinë, sociolinguistikën etj. (6)

Ndërsa, sa i përket kapitullit të fundit "Karakteristikat e të folmes së Prilepit dhe

Krushevës" autori na informon se popullata shqiptare e rrethit të Prilepit, përbëhet nga gjashtë fshatra, ndërsa popullata e rrethit të Krushevës përbëhet nga tetë fshatra me popullsi shqiptare. Dhe, meqë është fjala për rrethin e tij të lindjes, (fshati Cernilishtë e Prilepit), ai është i ambientuar me ta, me fshatarët e tij, me të folmen e tyre, zakonet, doket e tyre etj., Studiuesi Ibrahim, duke e studiuar nga afër këtë të folme, vije në përfundim se: "Në bazë të materialet të paraqitur mund të përfundohej se e folmja e shqiptareve të dhe Krushevës i përket grupit dialektor të gegërishtes qendrore dhe si e tillë çdo herë ka mbajtur lidhje të përhershme me të folmet tjera, të ngjashme të këtij grupi. Por kjo të folme me disa tipare dialektore toske, mund të radhitet edhe si e folme kalimtare".

Përfundim

Nga pozita e recensuesi që me përgjegjësi u thellova në vlerësimin e këtij botimi, konstatoj se komponimi i librit është zhvilluar me njohuri të larta profesionale. Duke të cekim se ka ende për tu mbledhur si nga proza gojore ashtu edhe nga lirika gojore.

Mbështetur në metoda të rrepta dhe objektive shkencore, me prova të pakundërshtueshme me këto tregime popullore, autori tregon të vërtetën dhe lashtësinë e popullit tonë dhe të gjuhës së tij në trojet e veta që i banon sot e ku ka banuar dikur, së paku që nga antikiteti. Për strukturën gjuhësore dhe stilistike të librit, autori jep një pasqyrë të përgjithshme dialektore, ku i përshkruan vijat e përgjithshme fonetike, morfologjike dhe leksikore të të folurit të trevës së Prilepit dhe Krushevës.

Marrë në tërësi, libri në brendësinë e vet përveç që na sjell zhanre të ndryshme të prozës popullore, na pasqyron të folmen e atij rajoni, gjithashtu ai na njeh me një mori rrëfimesh me një leksik të veçantë krahinorë e dialektor, duke e njohur lexuesin me kulturën, doket, zakonet, lojërat popullore etj. karakteristike për këtë rajon. Ndërsa autori Mustafa Ibrahim me këtë vepër të rëndësishme shkencore, e pasuruan folkloristikën shqiptare në përgjithësi dhe prozën popullore shqiptare në veçanti.

David Guetta shfaqet me të dashurën në Miami



Dji famshëm botëror David Guetta ka marrë pak kohë nga puna e tij për të shijuar çaste romantike me të dashurën në Miami. Ylli botëror, që po zhvillon një kon-

cert në Ultra Music Festival, është fotografuar duke u puthur me Jessica Ledon. 50-vjeçari dhe e dashura e tij po relaksoheshin në rrezet e diellit nën shoqërinë e njëri-tjetrit.

Di Caprio në lidhje me modeluesen 20-vjeçare



Aktori hollivudian Leonardo DiCaprio është i njohur për lidhjet e shumta me femrat shumë më të reja në moshë. Kohët e

fundit ishte spekuluar se 43-vjeçari është në lidhje me bukuroshen argentinase Camila Morrone. Ata janë parë së bashku në Kaliforni.



Gigi Hadid po lufton ta rifitojë zemrën e Zayn Malikit

Pas ndarjes së bujshme, Gigi Hadid raportohet se po lufton për ta fituar përsëri dashurinë e Zayn Malikit. 23-vjeçarja e ka treguar dëshirën e saj për një rikthim me këngëtarin në rrjetet sociale. Zayn ka pos-

tuar një fotografi në "Instagram" të të gjitha çmimeve që ka fituar këtë vit, ndërsa supermodeluesja ia ka pëlqyer postimin. A është kjo një dëshmi që ajo po vuan nga ndarja dhe dëshiron të rikthehet me Zayn, mbetet për t'u parë.

Ndahen Chrissy Metz dhe Josh Stancil



Chrissy Metz dhe Josh Stancil nuk janë më në lidhje. Aktorja dhe kameramani u takuan gjatë vitit 2016, ndërkaq lajmin për ndarjen e konfirmoi vetë

Chrissy në një intervistë të fundit. "Unë nuk jam në lidhje me askënd tani", ka thënë ajo. Chrissy Metz gjithashtu ka shtruar se të dy do të mbeten miq të mirë.

Veset e këqija të Xhorxh Uashingtonit

Në pronën e George Washington në Virxhinia, sot muze, gjendet një galeri me portretet e udhëheqësve revolucionarë që në fund u bënë keqbërës.

Jul Cezari, Oliver Kromuell dhe Napoleon Bonaparti, janë tre heronj që rrëzuan tiranitë vetëm për të rrëmbyer pushtet absolut për vete menjëherë pas fitores. Xhorxh Uashingtoni (George Washington) ishte ai që bëri diferencën dhe kjo është e mirënjohur. Në tregimet zanore dhe filmike të përgatitura për fëmijët, muzeu në Malin Vernon jep mesazhin se kryekomandanti i revolucionit amerikan dhe Presidenti i parë i Shteteve të Bashkuara pati një gjenialitet që mbijetoi edhe shumë kohë pasi ai u largua nga kjo botë.

Ekspozita tregon se si ai dorëzoi postin e komandantit ushtarak, pasi i mposhti britanikët. Aty gjendet edhe karrigia në të cilën ai vendosi të tërhiqet si president, dhe kjo konsiderohet si një pasuri kombëtare. Ekspozita tregon më tutje se virtyti më i lartë i

Virxhinia. Por fakti është se Uashingtoni ishte edhe një politikë. Megjithatë ata e kanë vënë fytyrën e tij te dollari dhe bustin mbi piedestale të pafundme, amerikanët duket se e kanë haruar këtë fakt. Mitologjia për Presidentin e parë errëson leksionet që ai mund të ketë për banorët e sotëm të qytetit që mban emrin e tij.

Dhe kjo është e turpshme. Në politikën e sotme, viti 1776 ndihet sikur të ishte pesë minuta më parë. Nuk është thjesht nga mitingjet e konservatorëve që mbanjnë kapelat e kohës. Fjalimet e republikanëve mbartin sot plot paralajmërime nga Madison mbi nevojën për të reaguar përballë fuqive të qeverisë, për sa kohë njerëzit nuk janë të sunduar nga engjëjt.

Xhefersoni, (Jefferson), si një radikal i qeverisë së vogël, është



dosi precedentë që vijojnë të ndihen. Si edhe udhëheqësit e tjerë ushtarakë që hyjnë në politikë, ai ishte shumë i kujdesshëm në lidhje me sigurinë kombëtare dhe i frikësuar nga lufta. Ai favorizonte neutralitetin në vend të aleancave të përhershme dhe fushatave ushtarake jashtë vendit. Ai ishte konservator nga pikëpamja fiskale, duke e nxitur vendin e tij të shpenzojë dhe të marrë hua me kujdes dhe jo të ngarkojë me borxhe gjeneratat e ardhshme.

Por ndryshe nga liberalët e ditëve tona, ai nuk e urrente taksimin; ai e quante atë të pakëndshëm, por të domosdoshëm. Si President ai dërgoi 13 mijë njerëz të milicive për të shtypur një kryengritje kundër taksave nga fermerët e uiskit.

Ai kishte edhe vanitetin dhe hipokrizitë e veta. Një vizitor i parregullt në kishë, ai nxiti religjionin për të tjerët si një mënyrë për të rritur moralin. Në lidhje me skllavërinë, të keqen e madhe të kohës së tij, ai luajti "liro dhe shtrëngo". Si një fermer zotëri, ai u kujdes që skllavërit e tij të lirohen, por vetëm pas vdekjes së tij dhe të bashkëshortes së tij. Si politikan i shqetësuar për unitetin kombëtar, ai ishte i gatshëm të shtynte për më vonë abolicionin e skllavërisë. Shumë

përpara thirrjes së Barack Obama-s për amerikanët për të shmangur ndarjen në shtete blu dhe të kuqe (demokratë dhe republikanë), Uashingtoni pa me tmerr politikën me parti.

Por pak a shumë si Obama, neutraliteti i Presidentit të parë qe disi mashtrues. Ai qeverisi një Amerikë të ndarë mes mbështetësve të lirive individuale dhe të drejtave të shteteve dhe atyre që mbështesnin një përqsasje më kolektive. Uashingtonianoi nga autoriteti federal, duke i nxitur qytetarët ta shohin qeverinë si "ne" dhe jo si një fuqi e largët e tiranike "ata". Mbajtësit e flakës në Malin Vernon kanë një plan për të rikthyer Uashingtonin si politikan në vëmendjen e amerikanëve sot. Pranë shtëpisë së tij të madhe me kolonada po ndërtohet ajo që ata e quajnë "biblioteka presidenciale", në stilin e 13 bibliotekave presidenciale që shërbejnë si arkiva, institute mendimi dhe kulte të ish-shefave të Amerikës, një traditë e filluar nga Frenklin Rusvelti (Franklin Roosevelt).

Kjo bibliotekë do të hapet në shtator dhe do të jetë teknikisht një "Bibliotekë Kombëtare", duke reflektuar statusin e Malit Vernon si një muze privat i pafinancuar nga qeveria. Por krijuesit po

mendojnë për ta promovuar heroin e tyre në mënyrë "agresive". Studiuesve po u ofrohet akses i paprecedentë në dokumentet e Uashingtonit, ndërsa shkrimtarëve po u ofrohen shërbime në tokat përreth muzeut. Interesi publik është rritur me një kopje me shënime të Uashingtonit, të Kushtetutës dhe të akteve të para të Kongresit, të cilat janë në ekspozim.

Udhërrëfimi në muze është dizajnuar në mënyrë të tillë që të krijojë një lidhje mes Uashingtonit dhe bibliotekës së tij. Shpëtimi i Uashingtonit nga piedestali Vetëm 20 kilometra më tutje lumit Potomak nga Kapitoli, prona është një vend i këndshëm për reflektim bipartizan, thotë Presidenti i Malit Vernon Curt Viebranz. Në një eksperiment fillestar, një grup prej tetë senatorësh, katër republikanë dhe katër demokratë, shkuan në Malin Vernon në tetor 2012 për të medituar mbi planin e reduktimit të deficitit që duhej të ishte i pranueshëm për të dyja palët, por bisedimet nuk sollën rezultat. Takime të tjera të tilla politike janë planifikuar. Uashingtoni parashikoi se partizanët do të përpiqen t'i vendosin amerikanët përballë njëri-tjetrit, duke lejuar një "minoritet sipërmarrësish" të rrëmbejnë vullnetin e deleguar të kombit. Megjithatë, në lamtumirën si President ai tha se amerikanët kanë sjellje të përbashkëta themelore, vese dhe parime politike. Pati një duhmë paternalizmi në mendimet e ushtarit të moshuar. Por në pikëpamje më të gjerë, ai kishte të drejtë. Amerikanët shpesh janë më të bashkuar sesa pretendojnë politikanët. Një dozë nga fryma e Presidentit të parë do t'i bëjë mirë Uashington DC-së.



Uashingtonit, më i madh sesa vetë suksesi i tij në fushëbetë, ishte pikërisht fakti se e dinte se kur duhej të tërhiqej, gjë që i garantoi vendit të tij një të ardhme të sigurt si republikë civile. Ka diçka të rëndësishme këtu: gjatë karrierës së tij, vetësakrifikimi ishte tipari i tij. Ai qe i gjatë, i shëndoshë dhe i rëndë më shumë sesa udhëheqësit e tjerë.

Ai vazhdimisht deklaronte se nuk dëshironte gjë tjetër veçse të tërhiqej poshtë pemëve të kopshtit të vet në pronën në

një hero i së djathtës liberale. Ortaku në garë i Mitt Romney në fushatën e vitit 2012, Paul Ryan, e ndërtoi fushatën e vet mbi leksionet e Xhefersonit duke theksuar se të drejtat e amerikanëve vijnë nga Zoti dhe natyra, jo nga qeveria. Nga e majta, liritë civile huazojnë gjithashtu shumë nga Xhefersoni, duke cituar urrejtjen e tij për censurën, si dhe armiqësinë për religjionin e financuar nga shteti. Vetë Uashingtoni citohehet rrallë.

Megjithatë, ai ka mendime të vlefshme edhe për sot dhe ven-



A janë të lumtur fëmijët e adoptuar?



Shumë nga historitë e deritanishme që kemi dëgjuar, lexuar apo që janë bërë të ditura nga media, na paraqesin të dhëna se fëmijët e adoptuar janë të zemëruar, jo të lumtur dhe kanë gjasa të ndërmarin veprime kriminale.

E vërteta ka mundësi të jetë ndryshe, pasi një familje, qoftë kjo edhe adoptuese, të jep mundësi më të mëdha shkolli-mi, zhvillimi emocional dhe shpirtëror. Këta fëmijë të adoptuar rriten për t'u bërë njerëz të zakonshëm dhe integrohen mirë me pjesën tjetër të shoqërisë. Në vitin 1994, Instituti i Kërkimeve të Minepolisit nxori rezultatet e "Të rriturit e adoptuar", një studim katërvjeçar. Kërkuesit analizuan 881 adoleshentë, 1.262 prindër adoptues dhe 78 vëllezër dhe motra të paadoptuar. U zbulua se adoleshentët e adoptuar kishin lidhje të forta me familjen e re dhe se ishin psikologjikisht të shëndetshëm.

Në fakt, adoleshentët e adoptuar kishin marrëdhënie më të

mira në lidhje me mirëkuptimin në familje, i ndihmonin më shumë të tjerët dhe miqësitë e tyre ishin më të shëndetshme sesa të personave që ishin të paadoptuar. Adoleshentët e adoptuar kishin gjithashtu arritje më të larta në studime, ishin më optimistë për jetën dhe ndiheshin më shumë të mbështetur nga familja dhe shkolla. Në vitin 2007, një raport i Departamentit Amerikan të Shëndetit u dha fund shumë prej dyshimeve, që binin mbi adoptimin e fëmijëve. Raporti i titulluar "Adoption USA", studioi 2000 familje që kishin adoptuar fëmijë në mënyra të ndryshme.

U zbulua se 85 për qind e fëmijëve ishin në gjendje shumë të mirë shëndetësore dhe shpirtërore. Këta fëmijë gjithashtu ishin më pak të prirë të jetonin në varfëri. Ata kishin edhe përparësi të tjera në lidhje me fëmijët biologjikë, pasi këtyre u lexoheshin më shumë përralla në fëmijëri, u tregoheshin më shumë histori dhe

merrnin më shumë pjesë në aktivitetet jashtëshkollore.

Mbi gjysma e fëmijëve të adoptuar kishte aftësi shumë të mira në lexim, në gjuhë të huaja dhe në matematikë. Duken se politikë dhe reja të adoptimit po u pëlqejnë shumë familjeve adoptuese, pasi janë më të hapura dhe u lejon fëmijëve që të takojnë lirisht familjet e tyre biologjike. Mënyrat sesi ruhen këto kontakte janë nga më të ndryshmet, që nga vizitat e telefonatat deri të shkëmbimi i letrave apo e-maileve.

Për më tepër, rreth 97 për qind të fëmijëve në moshën 5-vjeçare, e dinin se ishin të adoptuar. Një studim i vitit 2012, i titulluar "Openness in Adoption" raportoi se vetëm 5 për qind e adoptimeve të sotme janë të mbyllura, pra pa kontakte me familjen biologjike. Kërkimi tregon edhe për përfitimet që kanë fëmijët që ruajnë marrëdhëniet me familjen e originës. Në këtë mënyrë ata mund të marrin më shumë informacione rreth familjes së tyre, të dhënave mjekësore

ndër vite dhe pemës gjenalogjike. Të rinjtë që janë pjesë e adoptimeve të hapura kanë një kuptim tjetër për psikologjinë e adoptimit dhe për prindërit e tyre.


Adoleshentët e adoptuar shprehin se ruajtja e marrëdhënieve me familjen biologjike i ka ndihmuar ata shumë në pranimin e vetes dhe kuptimin e fizionomisë së tyre. Ata e kanë shumë më të thjeshtë t'i shpjegojnë gjërat që u ndodhin, kur e dinë se i kanë trashëguar nga dikush tjetër që është i ngjashëm me ta.

Të adoptuarit kanë gjithashtu ndjenja pozitive kundrejt nënave të tyre dhe shprehin se e kanë më të lehtë t'i falin, kur janë në dijeni të gjendjes që kanë kaluar. Psikologët e lidhin lumturinë e fëmijëve të birësuar me zhvillimin e shëndetshëm të identitetit të tyre. Këta fëmijë ndihen më të sigurt në lidhje me marrëdhëniet që kanë me familjet adoptuese, por nga ana tjetër edhe ruajtja e kontakteve me familjen e originës, i lejon ata të ndiejnë

lumturi, shëndet dhe të përqendrohen në gjërat që dëshirojnë të arrijnë nga jeta.

Adoptimi është një traditë e krijuar që nga antikiteti. Për shembull në Kodin e Hamurabit, jepeshin me detaje të drejtat e atyre që dëshironin të adoptonin dhe përgjegjësitë që kishin mbi individët që birësonin. Gjurmë të adoptimit gjenden edhe në Romën e lashtë në Kodin e Justinianit. Ndryshe nga sot, adoptimi atëherë bëhej jo vetëm nga personat që nuk mund të kishin fëmijë, por edhe nga ata që dëshironin t'ia trashëgonin pasurinë e tyre një personi të caktuar. Për këtë arsye, meshkujt ishin më të preferuar për t'u birësuar.

Ja disa persona të famshëm që janë të adoptuar: Stiv Xhobs; Eleonor Rusvelt; Edgar Alan Poe; Çarls Dikens; Aleksandri i Madh; Xhon Lenon; Leo Tolstoi; Merlin Monro; Mark Tuein; Nelson Mandela; Nat King Cole; Halle Berri



Autor: GAZMEND MORINA						AKTORI I FAMSHËM NË FOTO (shqip.)	DOKUMENTI QË PËRMBAN KËRKESËN PËR TË RISHQYRTUAR NJË VENDIM GJYQI (jurid.)	MI I VOGËL	FILM I YNI "... ISHIN KATËR"	BANORET E NJË SHTETI SKANDINAV	DY ZANORE	SHTET NË AMERIKËN VERIORE	EPOKA ERE	AXHAMI, I ...	SHTRESË E SIPËRME AJRI	ISH ATLETI AMERIKAN MONTGOMERI
VESHJE E SIPËRME PREJ SHAJAKU SI JELEK ME GAJTAN													AKTORI I FAMSHËM ... DAMON (shqip.)			
MBISHKRIMI NË NJË GUR VARRI													INTENSITET, TITAN BANOR I NJË SHTETI AZIATIK			
AKTORI TURK IMIRZALIOGLU											MË VJEN GJUMË DUKE NDENJUR ISH PORTIERI GJERMAN OLIVER					
INTERNATIONAL LEADERSHIP UNIVERSITY									PASANIKE							TRUP GJEOMETRIK
PREK LEHTË									DËM, SHERR QYTET I MADH NË SUEDI							BASHKËT. LLOJ BIME QË PËRDORËT GJERËSISHT SI USHQIM (sh.shq.)
ERMELINDA MEKSI								MUZIKANTI KISERI PARA QË MERRËN PËR NJË KOHË TË ÇAKTUAR NGA DIKUSH						FJALË POHUESE GJYNAH		
ISH FUTBOLLISTI I NJOHUR TURK KAHVECI (VILLARREAL)												SYSHTRËM-BËR MAJE KOCKE QË DEL NË KOKËN E NJË KAFSHE				
EPOKA ERE	NDARJE NË KLASA, RENDITJE	LIRIDASHËSI	I PARI I XHAMISË (pashq.)	SHENJË QË PËRFAQËSON NJË TINGULL MUZIKOR (sh.shq.)	ALESANDRO NESTA	EPOKA ERE	PËRSHTATJA E NJË SENDI NJË SENDI TJETËR	UTAH, LOUISIANA QËLLOVA RASTËSISHT NË NJË NGJARJE			PJESË E MISHTË QË MBULON DHËMBËT (sh.shq.) TOPI JASHTE LOJE					POPULL (turq.)
													ZOTËROJ DIÇKA SHUHET			
									ORGANIC USER INTERFACES BASHKËT.				NJËSIA E MATJES SË FUQISË SË RRYMËS VONIM (sh.shq.)			
					QËLLIM I PARAMENDUAR NEON, KALIUM				BASHKËT. LLOJ VEGJE MUZIKORE				NGASËSI I "FORMULA 1" SEBASTIAN SHOK			
							DY BASHKËTINGËLLORE SHTET NË AZI "... LANKA"		LLOJ AGRUME BASHKËT.						"TETOVA" FUTBOLLISTI KALOU (CHELSEA)	
			TË TESTUARIT SHARRËZ (shq.)							REGJISORJA ... GJONI PËRËMËR VETOR					BASHKËT. PJESË E AUTOMJETIT PËR TË MBAJTUR DREJTIMIN	
	MBARËSI GATESË E JONA (sh.shq.)			REPERI AMERIKAN BROWN (shqip.) DISIPLINË SPORTIVE				FLUTURAKE E SHPEJTË USHTARAKE (sh.shq.) SIPËR								FEMRA E ZGJEDHUR NË NJË KONKURS BUKURIE
					TERRITOR I IMAMIT LETRARI MARTIN								EMËR YNI MASHKULLI ANIJATA			
										DEGË MJEKËSISË DY BASHKËTINGËLLORE						
								LLOJ, SOJ KAFSHË E EGËR GJITARE (shq.)			ALBERTO TOMBA IDHASHË FALAS				SUPER MODELJA KATE ... KRITER	
									AKTORJA E NJOHUR ... TYLER BOSHTI				KËNGËTARE E NJOHUR SHQIPTARE ANALISTI POLITIK BLERIM ...			
EPOKA ERE	BUNAR	KLUB FUTBOLLI SPANJOLL JO I VJETËR													DEM, KA	ISH ATLETI MERLIN
				JACKSONVILLE INTERNATIONAL AIRPORT ADEM JASHARI				GRYKË E VULLKANIT NGA KU DEL LAVA ABËDIN REXHA							TEFIK OSMANI MIMOZA OSAJ	
					VENDËS VOLTI											
			JANI VRETO													
																PERËNDESHA E DASHURISË NË MITOLOGJINË ROMAKE

E rrallë

Diamanti blu, në ankand pas 300 vitesh

Gjatë 300 viteve të fundit ka qenë në duart e katër dinastive mbretërore evropiane. Por, në muajin maj, diamanti i jashtëzakonshëm blu 6.16 karatësh, "Farnese" do të dalë në shitje për të parën herë në historinë e tij, në shtëpinë e ankandeve "Sotheby's". Guri i errët blu, në formë dardhe, u zbulua në minierën "Golconda" të Indisë.



FOTO E DITES



Papa Francesku gjatë paraqitjes së tij për festën e Pashkëve

E jashtëzakonshme

Pulëbardha ia merr sandviçin nga dora

Një pulëbardhë ia ka rrëmbyer një sandviç nga dora e një turisteje në Venecia. Turistja amerikane e cila po shijonte sandviçin ulur në stolat e sheshit San Marco, "u sulmua" nga shpendi pa qenë në gjendje të reagojë. Me sqepin e saj të madh, pulëbardha i mori sandviçin nga dora gruas pa e prekur fare atë.



BARSOLETA E DITËS



Mësuesit dhe Nxënësit:

-Në shkollë mësuesja po shpjegonte: Unë studioj, ti studio, ai ajo studio. Çfarë kohe është Toni. Është kohë e humbur mësuese!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC


Vetem gjatë vikendit në ora 14:30

"BLACK PANTHER"

3D (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 2 orë 15 min

Rolet: Chadwick Boseman, Angela Basset, Michael B. Jordan, Lupita Nyong'o, Martin Freeman, Forest Whitaker, Andy Serkis, etj.
Regjia: Ryan Coogler




Në ora 17:00

"PETER RABBIT"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 33 min

Rolet: James Corden, Rose Byrne, Domhnall Gleeson, Sam Neill, Daisy Ridley, Elizabeth Debicki, Margot Robbie, etj.
Regjia: Will Gluck



Në ora 19:00

"PACIFIC RIM UPRISING" (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 1 orë 51 min

Rolet: John Boyega, Scott Eastwood, Jing Tian, Cailee Spaeny, Rinko Kikuchi, Burn Gorman, Adria Arjona, Charlie Day, etj.
Regjia: Steven S. DeKnight



Në ora 21:00

"RED SPARROW" (R)

Mister/Triller; 2 orë 25 min

Rolet: Jenifer Lawrence, Joel Edgerton, Matthias Schoenarts, Jeremy Irons, Mary-Louise Parker, Charlotte Rampling, etj.
Regjia: Francis Lawrence



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI

Mjafton të nisni aty ku e keni ndërprerë punën dhe do të shikoni që askush nuk mund t'ju akuzojë se nuk arritët ta përfundoni në kohë.



DEMI

Dite e shkëlqyer nga ana profesionale. Do të keni shumë takime por edhe shumë finalizime mjaft të mira financiare të kontratave të mëparshme.



BINJAKËT

Keni nevojë të ambientoheni sërisht me vendet ku keni munguar për njëfarë kohe. Tani që jeni rikthyer keni nostalgjinë e miqve të vjetër.



GAFORRJA

Këtë periudhë jeni mjaft të ndjeshëm ndaj çështjeve të zemrës. Një kritikë që do t'ju bëjë një person i afërt do t'ju prekë me shume seç duhet.



LUANI

Keni zgjedhur mënyrën me të mirë për të ekuilibruar jetën profesionale dhe atë sentimentale. Në këtë mënyrë do të dini të kënaqni këdo.



VIJGJËRËSHA

Sot doni të jeni të sigurt që asnjë nuk do t'ju rrezikojë në rrugën tuaj. Keni filluar të rikonsideroni të gjitha raportet e mëparshme.



PESHORJA

Keni bërë shumë për veten që të ndiheni të mbushur shpirtërisht dhe në paqe me veten. Me disa ndryshime të vogla sot do të ndiheni mjaft mirë.



AKREPI

Po kërkon një mënyrë se si të mos ju vrasë ndërgjegjja sepse jeni koshientë që kohet e fundit keni bërë shumë veprime të gabuara.



SHIGJETARI

Sot do të shikoni që më në fund puna dhe mundi juaj po vlerësohen siç duhet. Keni kohë që e prisni këtë reagim dhe sjelljet sot do t'ju lumturojnë.



BRICJAPI

Ka situata që sot do të zhvillohen krejt ndryshe nga ajo që kishit imagjinuar. Do t'ju lëdojnë sidomos në fushën personale.



UJORI

Doni të jeni në qendër të situatave të ndryshme por harroni që nuk mund të kontrolloni dot gjithçka. Sigurisht do të këtë detaje që do t'ju shpëtojnë.



PESHQIT

Nëse nuk doni të keni probleme me afatet kohore sot mundohuni të zgjidhni gjithçka brenda kohës që keni programuar që herët.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adri: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

BURTON ALBION - MIDDLESBROUGH

3+

PRESTON - DERBY

1

DONCASTER - AFC WIMBLEDON

4+

Drita, 3 pikë para Prishtinës



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 1 PRILL - Skuadra e Dritës ka fituar ndeshjen ndaj Flamurtarit dhe ka shtuar diferencën ndaj Prishtinës në tri pikë, pasi kryeqytetasit kanë luajtur baras me Vëllaznimin. Derbi i kësaj xhiroje në mes të Feronikelit dhe Llapi përfundoi baras, kurse fitoreve të dielën i janë gëzuar Gjilani dhe Trepça '89 në ndeshjet ndaj Vllaznisë dhe Drenicës. E veçanta e kësaj xhiroje ishte se tri nga gjashtë ndeshjet e zhvilluara kanë përfunduar me rezultat 2-2.

Feronikeli - Llapi 2-2

Feronikeli dhe Llapi kanë ndarë pikët në derbin e xhiros së 28-të, pasi kanë luajtur baras 2-2. Vendësit shënuan golin e parë pas dhjetë minutave lojë. Autor i golit ishte anësori Mark Milicaj. Mysafirët arritën ta barazojnë rezultatën me golin e kapitenit Hamdi Namani (33), kurse epërsinë e parë mysafirët e arritën pesë minuta pa përfunduar pjesa e parë e ndeshjes, kurse shënues ishte Ilir Blakqori. Albutrint Morina në fillim të pjesës së dytë e barazoi rezultatën në 2-2, kurse në vazhdim të ndeshjes gola të tjerë nuk pati dhe skuadrat ndanë nga një pikë.

Trepça '89 - Drenica 1-0

Sulmuesi më i mirë i edicionit të kaluar, Otto John, ishte hero i Trepçës '89 në ndeshjen ndaj Drenicës, pasi shënoi golin e vetëm të ndeshjes. Pjesa e parë e ndeshjes së zhvilluar të dielën në "Riza Lushta" përfundoi 0-0, kurse dhjetë minuta para fundit John realizoi golin e fitores, pas një gabimi të portierit Flamur Neziri. Pas kësaj ndeshje '89-shi ngrehet në kuotën e 39 pikëve, kurse Drenica ka grum-

bulluar tri pikë më pak. Në xhiron e radhës Trepça '89 i shkon Feronikelit në Drenas, kurse Drenica luan në Gjakovë ndaj Vëllaznimit.

Gjilani - Vllaznia (P) 4-0

Gjilani më lehtë sesa që është pritur e ka fituar ndeshjen ndaj skuadrës së Vllaznisë së Pozharanit (4-0). Në këtë ndeshje ka shkëlqyer Betim Haxhimusa që shënoi tre gola, kurse golin e parë e shënoi Fisnik Papuqi. Pas kësaj xhiroje Gjilani ka grumbulluar 39 pikë, kurse Vllaznia mbetet në kuotën e 13 pikëve, kurse do ta ketë mjaft vështirë ta sigurojë pozitën e barazhit.

Prishtina - Vëllaznimi 2-2

Prishtina ka dëshpëruar të gjithë tifozët e vet, pasi e ka lëshuar fitoren nga duart në ndeshjen ndaj Vëllaznimit nga Gjakova (2-2). "Bardhekaltrit" në fillim të pjesës së dytë shënuan të parët nëpërmjet Gathier Mankendas, kurse epërsinë në 2-0 e shtoi Ergyn Ahmeti në minutën e 86. Kur pritej që Prishtina ta festoj fitoren, doli e kundërta, pasi kuqezinjët shënuan dy gola në minutat shtesë. Autorë të golave ishin Besnik Krasniqi nga penalltia dhe Lekë Vula. Pas këtij barazimi Prishtina është e dyta dhe ka tri pikë më pak se skuadra e Dritës, kurse Vëllaznimi është në pozitën e nëntë me 32 pikë.

Drita - Flamurtari 3-1

Skuadra e Bekim Isufit, Drita, e ka shtuar diferencën e pikëve ndaj Prishtinës në tri sosh, pasi kryeqytetasit barazuan në ndeshjen ndaj Vëllaznimit. Skuadra e Dritës, që është një prej favoriteve kryesore për titull, e mposhti të shtunën skuadrën e Flamurtarit me rezultat 3-1. Pas dy minutave lojë, Bujar

Shabani e kaloi Dritën në epërsi, kurse Flamurtari i barazoi shifrat në minutën e 54-t, me golin e Shqipdon Ademit. Gjilanasit nuk u ndalën dhe shënuan edhe dy gola të tjerë me anë të Haxhi Nezirajt dhe Xhevdet Shabanit për t'i siguruar tri pikët e plota.

Vala SUPERLIGA	
Trepça '89-Drenica	1-0
Gjilani-Vllaznia	4-0
Feronikeli-Llapi	2-2
Drita-Flamurtari	3-1
Prishtina-Vëllaznimi	2-2
Liria-Besa	2-2

Tabela	
1. Drita	47 pikë
2. Prishtina	44
3. Liria	42
4. Feronikeli	39
5. Llapi	39
6. Gjilani	39
7. Trepça '89	39
8. Drenica	36
9. Vëllaznimi	32
10. Besa	18
11. Flamurtari	15
12. Vllaznia	13

Në xhiron e radhës takohen: Feronikeli-Trepça '89, Llapi-Gjilani, Vllaznia-Liria, Besa-Drita, Flamurtari-Prishtina, Vëllaznimi-Drenica.

LIGA E PARË	
Onix Banja - Kika	0-2
Dukagjini - Ramiz Sadiku	0-1
Vushtrria - Vitia	1-0
Trepça - Bashkimi	0-3
Rahoveci - Hajvalia	3-1
Kosova - Ballkani	0-1
Ferizaj - KEK-u	2-0
2 Korriku - Fushë-Kosova	1-0

Tabela	
1. KEK-u	49 pikë
2. Vushtrria	48
3. Ballkani	48
4. Ferizaj	43
5. Onix	37
6. Fushë-Kosova	37
7. Ramiz Sadiku	31
8. Dukagjini	29
9. 2 Korriku	29
10. Vitia	28
11. Bashkimi (K)	28
12. Trepça	26
13. Rahoveci	23
14. Kika	23
15. Hajvalia	23
16. Kosova (P)	7

SHKURT

Reagon ShGSK-ja: Klubet serbe mos të luajnë në Kosovë

Shoqata e Gazetarëve Sportivë të Kosovës (ShGSK) shprehet e indinjuar me lejimin e ndeshjeve paralele të skuadrave nga Serbia në territorin e Kosovës. Të shtunën, më 31 mars, u zhvillua ndeshja hendbollistike në mes të Mokra Gora - Obiliq në Zubin Potok. "Ftojmë organet përgjegjëse të reagojnë për të ndalur këtë trend që po haset edhe në shumë sporte të tjera. Kjo nuk është hera e parë që klubet serbe zhvillojnë aktivitetet e tyre kampionale në Kosovë duke shprehur qartë mohimin e shtetit të Kosovës, madje nuk kanë qenë të rralla rastet kur kanë nxitur provokime të ndryshme. Andaj, kërkojmë nga institucionet përkatëse të jenë më vigjilentë dhe t'i marrin masat e duhura në këtë drejtim", thuhet në reagimin e ShGSK-së.

Prishtina mezi e fitoi derbin ndaj Kastriotit

Prishtina ka shënuar fitore me vetëm një gol dallim ndaj Kastriotit, në derbin e javës së 22-të të Superligës A të Kosovës në hendboll për meshkuj. Prishtina fitoi ndaj ferizajasve me rezultat 26:25. Pas pjesës së parë rezultati ishte 15:14 dhe epërsia prej një goli ishte edhe në fund të ndeshjes. Terziqi me nëntë gola ishte më efikas te Prishtina, kurse gjashtë gola i shënoi Fetahu. Te Kastrioti nga shtatë herë realizuan Sylja e Haxhimusa. Prishtina është e dyta me 40 pikë, kurse Kastrioti i treti me 24.

Muriqi dy gola për Rizesporin

Sulmuesi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Vedat Muriqi, ka shënuar dy gola në fitoren 3-2 të Rizesporit kundër Istanbulspor (2-3). Muriqi shënoi dy golat e parë për skuadrën e tij, kurse të tretin e shënoi Suleyman Koc.

Nishevci, i pesti në ranglistën botërore

Karatisti i njohur nga Kosova, Herolind Nishevci, ka hyrë në top-pesëshen e ranglistës botërore. Ai tani është i pesti në kategorinë mbi 84 kilogramë. Nishevci nga pozita e dhjetë është ngritur në të pestën në kategorinë e tij.

Kosova nuk do të përballet kurrë me Serbinë

Hendbolli serb kurrë nuk do të zhbillojë më ndeshje me Përfaqësuesen e Kosovës. Ky pohim vjen nga presidenti i Federatës së Hendbollit të Serbisë, Dragan Skrbiq. Ai ka treguar se kanë arritur një marrëveshje me Federatën Evropiane të Hendbollit. Sipas kësaj marrëveshje, edhe nëse shorti përcakton që këto skuadra të ndeshen me njëra-tjetrën, do të duhet të hidhet sërish një short i ri. "Federata e Hendbollit e Serbisë ka arritur marrëveshje që ekipet serbe, përfshirë edhe kombëtaren e hendbollit, nuk do të ndeshen me Kosovën apo ekipet e saj", ka thënë Skrbiq. Ndërkohë edhe xhudistet serbe nuk janë lejuar të zhvillojnë ndeshje me homologet e tyre kosovare. Lajm tjetër është se Kosova ka paralajmëruar se do të marrë pjesë në Kampionatin Evropian të Karatesë që do të mbahet pikërisht në shtetin serb.

Prekazi: Kosova, tokë e talenteve

PRISHTINË, 1 PRILL - Trajneri i Kosovës U21, Rafet Prekazi, ishte i ftuar në një lidhje të drejtpërdrejtë nga Mitrovica për emisionin 'Zona Gol', mbrëmjen e të shtunës në "Supersport". I pyetur se a ka dallim mes talenteve shqip-

tarë të Kosovës dhe atyre të Shqipërisë, Prekazi është përgjigjur: "Për më të suksesshëm as që diskutohet, pasi lojtarët e Kosovës prej vitesh kanë luajtur në nivele të larta dhe këtu u referohem Vokrrit, Prekazit etj. Kosova

është realisht toka e talenteve dhe ka shumë lojtarë që mund të bëjnë emër në futboll. Te ne futbollit ende luhet nëpër rrugë, pasi nuk ka kushte, por për t'u përmirësuar duhet shumë punë. Gjithsesi, Kosovë apo Shqipëri, jemi të gjithë

shqiptarë dhe nuk duhet t'u mëshojmë të tilla dallimeve. Duhet të jemi të vetëdijshëm të punojmë me të rinjtë, sepse koha punon dhe duhet shumë punë dhe angazhim për të garuar në Evropë", ka thënë Prekazi.



Bostoni, leksion Torontos, Golden State rikthehet te fitorja

BOSTON, 1 PRILL - Vazhdon momenti i mirë për Boston Celticsin në NBA. Në të Garden nga Massachusetts fitoi duelin mes dy skuadrave më të mira të Konferencës së Lindjes duke mbajtur gjallë shpresat për ta mbyllur sezonin e rregullt në vendin e parë. Edhe pse pa yllin e skuadrës Kyrie Irving që nuk është rikuperuar ende nga dëmtimi, Celticsi tregoi të gjithë potencialin përballë Toronto Raptorsit duke e mposhtur skuadrën kanadeze me rezultatin 110-99. Kjo ishte fitorja e gjashtë radhazi për Bostonin që numëron 53 suksese në total në këtë sezon, 2 më pak se Toronto që kryeson klasifikimin në Lindje. Marcus Morris me 25 pikë dhe Jayson Tatum me 24 ishin dy basketbollistët më të mirë mbi parket për skuadrën më të titulluar të NBA-së, ndërkohë që miqve nuk u mjaftuan 32 pikët e realizuara nga ylli i ekipit DeMare DeRozan. Pas tri humbesh radhazi rikthehet te suksesi Golden State Warriorsi. Kampionët në fuqi triumfuan me rezultatin 112-96 në transfertën kaliforniane ndaj Sacramento Kingsit për meritë të dyshes Kevin Durant-Klay Thompson. I pari realizoi 27 pikë në këtë sukses të thjeshtë të skuadrës nga Okalanda, ndërsa Thompson e mbylli sfidën me 25 pikë. Me Durantin dhe



Thompsonin që kanë rigjetur formën tashmë pritet edhe rikthimi i Steph Curryit nga dëmtimi që Golden State të rikthehet të jetë sërish ajo skuadra e frikshme që i tremben të gjithë, raporton "Supersport". Një hap të sigurt drejt kualifikimit në "play-off" hodhi Washington Wizardsi. Falë 26 pikëve të Otto Porterit dhe 22 të Bradley Beal skuadra kryeqytetase mposhti në "Capital One Arena", Charlotte Hornets me rezultatin 107-93, duke blinduar vendin e 6-të në Lindje. Humbje shokuese për Miami Heat që u mposht brenda në Florida pas kohës shtesë nga

Brooklyn Netsi me rezultatin 110-109, megjithatë formacioni i Eric Spoelstras, pavarësisht prej kësaj disfate, për momentin nuk e rrezikon vendin e 8-të në Konferencën e Lindjes që është edhe pozicioni i fundit që të kualifikohet në "play-off".

REZULTATET

Washington - Charlotte	107-93
New York - Detroit	109-115
Boston - Toronto	110-99
Miami - Brooklyn	109-110
Sacramento - Golden State	96-112

Joshua mposhti edhe Parkerin

CARDIFF, 1 PRILL - Boksieri britanik Anthony Joshua mundi me vendim unanim të gjyqtarëve neozelelandezin Joseph Parker, duke mbetur kështu kampion bote në peshat e rënda në kategoritë IBF, WBA, tituj që i kishte vetë edhe më parë, duke i rrëmbyer rivalit titullin e kategorisë WBO. Kjo sfidë mes dy boksiereve të pamposhtur deri para këtij dueli nuk ishte shumë spektakolare, një duel taktik, ku boksiertë zbatuan planet që kishin përgatitur. Një duel me 12 raunde zhvilluar në Cardiff, ku Joshua u tregua më agresiv, duke korrur suksesin e 21-të në karrierë në po kaq sfida të zhvilluara (20 fitore i ka me KO). Tri raundet e para ishin të qetë, pa shumë emocione, ku boksiertë më së shumti studiojnë njëri-tjetrin dhe munguan grushtet e fortë, por gradualisht sfida nisi të bëhej më spektakolare, me britaniku që filloi ta godasë rivalin në fytyrë. Raundi i gjashtë ishte mjaft i bukur, Parker vë në veshiturësi Joshua dhe nis të rikuperojë në



pikëzim, duke e bërë duelin edhe më tërheqës. Por në raundin e 10-të Parkeri pëson një të çarë në vetulën e majtë nga grushtet e Joshuas, që ruan një avantazh të lehtë. Britaniku ruan avantazhin deri në fund, duke e merituar fitoren, ndërsa Parkeri pëson humbjen e parë në karrierën e tij pas 24 fitoresh. Dy

nga gjyqtarët dhanë pikëzimin 118-110, ndërsa njëri prej tyre 119-109, të tri në favor të Joshuas, që për herë të parë zhvillon një duel deri në raundin e 12. Britaniku u shpreh pas duelit se është gati për sfidën me Wilderin, kampionin e kategorisë WBC, por për të çdo sfidë është një biznes.

SHKURT

Salahi merr 1 milion vota në zgjedhjet presidenciale

E çmendur ajo që ndodh në Egjipt. Në zgjedhjet presidenciale, në të cilat triumfoi Abdel Fatah Al Sisi, Mohamed Salah mori 5% të votave, një milion të tilla. Ta mendosh që nuk ka qenë kandidat. Por dashuria e madhe që kanë njerëzit për këtë personazh në Egjipt ka bërë që një milion vota të dilnin të pavlefshme, pasi qytetarët kishin shkruar emrin e sulmuesit të Liverpoolit. Kualifikimi i Egjiptit në Botëror nga Sahal ishte një ngjarje e madhe dhe qytetarët nuk e harrojnë kurrë emocionin që ua dhuroi.

Griezmanni refuzon Unitedin për Barcelonën

Sulmuesi francez Antoine Griezmann nuk ka ndërmend të largohet nga La Liga, ndaj ka vendosur ta pranojë ofertën 100 milionë euro që i ka bërë skuadra e Barcelonës, duke refuzuar një tjetër ofertë që ka ardhur nga Manchester Unitedi, lajm që konfirmohet nga e përditshmja britanike "The Sun". Duket se edhe oferta e bërë nga skuadra "blaugrana" është shumë më e lartë për sulmuesin e Atletico Madridit, që është në kërkim të një ekipi ku mund të triumfojë në Ligën e Kampionëve.

Allegri: Për titullin na duhen 99 pikë


Juventusit fitoi 3-1 ndaj Milanit në përballjen e së shtunës, duke e çuar në katër pikë diferencën me ndjekësin më të afërt në Serinë A, por trajneri Massimiliano Allegri kërkon nga ekipi të qëndrojë me këmbë në tokë. Sipas teknikut të kampionëve të Italisë, për titullin duhen 99 pikë. "Mungojnë ende tetë ndeshje dhe për ta marrë kampionatin do të na duhet të fitojmë 7 prej tyre. Le t'i marrim hapat me radhë, pasi aktualisht pikët që kemi nuk na mjaftojnë as për t'u kualifikuar në Ligën e Kampionëve, pasi të gjitha skuadrat e tjera po ngjiten. Ishte e rëndësishme të riktheheshim te fitorja, ndaj një Milani që tregoi se është një skuadër e mirë", ka thënë Allegri.

Gattuso: Rezultati ndaj Joves, zhgënjyes

Milani ka pësuar humbje në ndeshjen derbi ndaj Juventusit 3-1. "Rossonerët" patën një paraqitje tejet të mirë, por në fund vendosi përvoja e lojtarëve torinezë të cilët shënuan dy gola dhe fituan ndeshjen 3-1. Për këtë humbje ka folur edhe trajneri i Milanit, Gennaro Gattuso. "Kjo ndeshje më dukej si ajo kundër Arsenalit e zhvilluar në Londër. Rezultati është mashtrues nga ajo që treguam në fushë. Ne duhet të rikthehemi menjëherë që nga ndeshja e radhës. Kemi një qëllim dhe duhet t'ia arrijmë", ka thënë Gattuso.

Pogba: Pyesni Mourinhon pse luaj kaq pak

Mesfushori Paul Pogba e pranon se nuk është mësuar të qëndrojë në bankën rezervë. "E pranoj që nuk jam mësuar me stolin, pasi kurrë më parë nuk kam qenë i detyruar të qëndroj ulur dhe ta shoh skuadrën duke luajtur. Por kjo situatë më ka bërë më të fortë, pasi këto ngjarje të bëjnë më të fortë dhe lufton më shumë për të ecur përpara", deklaroi Pogba. "Mourinho? Nuk kam probleme me të. Nuk jam unë ai që bën skuadrën. Pyesni atë se përse unë luaj kaq pak. Unë respektoj zgjedhjet e tij", ka shtuar Pogba.



Revistën për kulturë, gjuhë, media, "Akademia", mund ta gjeni në redaksinë e gazetës "Epoka e re", në Sheshin "Edit Durham", 100 metra larg "Grand Hotel"-it. Për informata të tjera mund të thërrisni në këtë numër të telefonit: +377 44 127 434.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se shoqëria » SPSS CONSULTING « SH.P.K., me seli në Prizren, rruga: William Walker, pn., ka marrë vendim që ta shuaj Shoqërinë me NRB dhe NRF. 810036477 me likuidim vullnetar dhe e ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së likuidimit vullnetar.


I njoftojmë të gjithë klientët që kanë raporte kreditore-debitore me këtë shoqëri që të paraqiten në afatin prej 30 ditësh nga data e shpalljes së likuidimit vullnetarë në gazetë.

OBAVEŠTENJE

Obaveštavamo sve kliente da društvo: » SPSS CONSULTING « D.o.o., sa sedištem u Prizrenu, ulica: William Walker, bb., doneo je odluku o gašenju društva sa REG.Br. i FBR. 810036477 putem dobrovolne likuidacije i ujedno imenovao likuidatora o vodjenju postupka dobrovoljne likuidacije. Obaveštavaju se svi klienti koji imaju potraživanja i obaveze u navedenom društvu, da se jave u roku od 30 dana od dana oglašavanja dobrovoljne likuidacije u novini.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the company: » SPSS CONSULTING « L.L.C., based in Prizren, street: William Walker, no number., has decided to extinguish its Society of Registry and Fiscal No. 810036477. The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly requested to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement publication.



Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira për një qift në Fushë Kosovë. Banesa duhet të ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë të jetë e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m². Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira në Prishtinë, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet të ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, truall frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, truall frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektesë si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

► Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Kërkohet kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira kati i parë, në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info: 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

► Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel: 044/171-328.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

URGJENTISHT KËRKOJ BANESË PËR ZYRE ME QIRA

Në qendër të Prishtinës, kërkohet banesë me qira, për zyrë. Hapësira 80-100m².

Kati i -I- deri në katin -III-.
Tel: 044741155

Lajmërohen bashkëpronarët e ngastrës kadastrale P-70202016-0440 bk-O, se bashkëpronari Arif Gërxfhalu ka shprehur dëshirën që të ashes një pjesë të pronës së vet. Andaj njoftohen bashkëpronarët e kësaj parcele kadastrale që nëse janë të interesuar për blerjen e kësaj parcele-pjesën e pronës të lajmërohen te bashkëpronari Arif Gërxfhalu.

LËSHOJ LOKALIN ME QIRA.

Lokali gjendet në rrugën "Isa Kastri" në Matiqan të Prishtinës dhe ka një hapësirë prej 400 m². Lokali është i gatshëm dhe shumë funksional. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-509-077.

Urgjentisht kërkohet një shtëpi me qira në Prishtinë. Shtëpia duhet të jetë e veçantë, duhet të ketë 5 ose 6 dhoma gjumi. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel 049-472-770

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m². Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m², dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkohet 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qerimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

► Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Afati i paraqitjes prej 03.03.2018
deri më 10.03.2018**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

*Gjithmon me marr malli per vone tem
Urime dita e pavaresise!*

**RC
cola**

*Urime perjetori i 10 Kosove
Shpresoj qe 10 vjetoria e ardhshem
fanzijet e me kane me qare krenar
me kane ba ne sot.*

*Ndoshta ka shume puna qe me arret a
ka duhet por e di qe keta ka njerez qe
shume dhe kane besim ne ardhmerine e*

*Sot 10 vjet kjo dite ka qare anderr per n
Qe prej asaj dite ure besoj qe puna m
gjithmore ktheshet! Urime Kosova jone!
Zemra pushon vec keta!*

**10 mesazhe
Kosoves**

**MADE IN
KOSOVA**

*Shpresoj ma t'nirer per Kosoven
e qe vitet e ardhshme tjere ma tsuksesshore
Gezuar perjetori i pavaresise!*